



# VLERËSIM I PROCESIT TË KTHIMIT VULLNETAR NË KOSOVË



Nëntor 2019



VLERËSIM I  
**PROCESIT TË KTHIMIT**  
**VULLNETAR**  
NË KOSOVË

Nëntor 2019

# PËRMBAJTJA

<b>PËRMbledhje Ekzekutive</b> .....	5
<b>1. Hyrje</b> .....	7
<b>2. Informata të përgjithshme</b> .....	9
<b>3. Zbatimi i kornizës ligjore dhe të politikave</b> .....	12
3.1 Korniza ligjore e Kosovës legal framework.....	12
3.2 Korniza e politikave e Kosovës .....	13
3.3 Drejt një rregulloreje për kthimin .....	14
3.4 Funksionimi i mekanizmave të kornizës së politikave .....	16
<i>Zyrat komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK)</i> .....	16
<i>Grupet punuese komunale për kthim (GPKK)</i> <i>dhe task forcat komunale për kthim (task forcat)</i> .....	17
<i>Strategjitë komunale për kthimi</i> .....	20
<b>4. Çështjet pronësore</b> .....	21
<b>5. Çështjet e sigurisë</b> .....	25
5.1. Siguria e të kthyerve dhe në vendet e kthimit.....	25
5.2 Reagimet e institucioneve të Kosovës ndaj incidenteve të sigurisë.....	25
<b>6. Komuniteti pritës dhe procesi i kthimit</b> .....	27
6.1 Pozicioni i komunitetit pritës.....	28
6.2 Reagimet komunale ndaj kundërshtimit të kthimit .....	29
6.3 Deklaratat ndërkomunale të lehtësuara nga OSBE .....	31
<b>7. Aspektet rajonale: procesi i shkupit</b> .....	33
<b>8. Konkluzat</b> .....	37
<b>9. Rekomandime</b> .....	39

## LISTË E SHKURTESAVE

<b>AKKVP</b>	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
<b>AKP</b>	Agjencia Kosovare e Pronës
<b>AKP</b>	Agjencia Kosovare për Privatizim
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>BPRM</b>	Byroja e Popullsisë, Refugjatëve dhe Migracionit
<b>FNL</b>	Forumi i Nivelit të Lartë
<b>GKPK</b>	Grupi Komunal i Punës për Kthim
<b>GTP</b>	Grupi Punues Teknik
<b>IOM</b>	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
<b>KDR</b>	Këshilli Danez për Refugjatë
<b>KKK</b>	Komisioni Komunal për Kthim
<b>KKSB</b>	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
<b>KQSH</b>	Komisioni Qendror Shqyrtues
<b>KRK</b>	Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë
<b>MKK</b>	Ministria për Komunitete dhe Kthim
<b>Nën-GPZ</b>	Nën-grupi Punues për Zbatim
<b>OJQ</b>	Organizatë Joqeveritare
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>PK</b>	Policia e Kosovës
<b>UNHCR</b>	Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
<b>UNMIK</b>	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
<b>VSHI</b>	Vizita shko dhe informohu
<b>VSHSH</b>	Vizita shko dhe shih
<b>ZKKK</b>	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

E drejta e personave të zhvendosur për tu kthyer në shtëpitë e tyre në siguri dhe dinjitet, si dhe për të rikuperuar pronat dhe pasuritë e tyre është e mishëruar si në kornizën ligjore të Kosovës ashtu edhe në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të zbatueshme në Kosovë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Në përputhje me mandatin e vet për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) vazhdon që ta mbështesë procesin e kthimit në Kosovë, t'i monitorojë trendet dhe ta vlerësojë efikasitetin institucional për zbatimin e kornizës ligjore dhe të politikave. Në këtë raport paraqitet pasqyrë e gjendjes aktuale për kthimet vullnetare në Kosovë, përfshirë personat e zhvendosur brenda vendit dhe personat e zhvendosur në rajon. Raporti mbulon periudhën nga janari i vitit 2015 deri në dhjetor të vitit 2018 dhe paraqet informata të përditësuara të raportit të OSBE-së për kthimin vullnetar të publikuar në vitin 2014.

Që nga viti 2014, institucionet e Kosovës kanë shënuar edhe më tepër përparim për të trajtuar nevojat e popullsisë së prekur. Elementet kyçe ishin zhvillimi i akteve të veçanta ligjore, bashkëpunimi i përmirësuar rajonal në kuadër të "Nismës ndërinstitucionale për personat e zhvendosur nga Kosova" që është filluar dhe lehtësuar nga OSBE dhe UNHCR, ndryshe i njohur si procesi i Shkupit si dhe zbatimi i vazhdueshëm i programit për kthim dhe riintegrim në Kosovë. Përkundër përparimit që është identifikuar, ka ende pengesa në disa fusha që ndikojnë në aftësinë e personave të zhvendosur për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme.

Ndonëse gjatë periudhës së raportimit nuk ka pasur legjislacion primar efektiv në fuqi që do të rregullonte procesin e kthimit, është shënuar përmirësim i konsiderueshëm pasi Qeveria e Kosovës, në janar të vitit 2018, miratoi Rregulloren për kthim të personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme. Rregullorja paraqet hap të rëndësishëm në përkushtimin e Qeverisë ndaj këtij procesi dhe konsolidimin e procedurave mes mekanizmave të ndryshëm institucionalë që janë aktivë në procesin e kthimit, duke e vendosur Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK) qartas në krye të këtij bashkërendimi. Rregullorja ka shfuqizuar mekanizmat e vjetër bazuar në kornizën e politikave<sup>1</sup> dhe për herë të parë në 19 vite ka themeluar një kornizë obligative për procesin e kthimit. Tani nevojiten përpjekje për ta zbatuar në mënyrë të duhur këtë rregullore, duke qenë se puna e mekanizmave gjegjës komunalë mbetet e kufizuar dhe shpeshherë është e lidhur me projektet e financuara nga donatorët, nevojitet edhe përmirësim në bashkërendimin mes mekanizmave të ndryshëm.

Hap tjetër pozitiv ishte miratimi i Strategjisë së Kosovës për të Drejtat Pronësore në tetor të vitit 2016 nga Qeveria e Kosovës, që përfshin politikat që sigurojnë të drejtat pronësore të personave të zhvendosur. Mirëpo, mbrojtja dhe promovimi i të drejtave pronësore dhe banesore shpesh minohen nga reagimi i pamjaftueshëm ndaj ri-uzurpimit të paligjshëm dhe nga mangësitë në ekzekutimin e vendimeve pronësore, si dhe në sigurimi i kompensimeve për të kthyerit, prona e së cilëve është shkatërruar apo dëmtuar si pasojë e konfliktit dhe në gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për të kthyerit pa tokë.

---

<sup>1</sup> Para miratimit të kësaj Rregulloreje procesi i kthimit është drejtuar nga *Manuali i rishikuar për kthim të qëndrueshëm*, i miratuar në korrik 2006.

Gjendja e përgjithshme e sigurisë në Kosovë, përfshirë vendet e kthimit, mbetet e qëndrueshme, por incidentet që po përsëriten – madje edhe nëse nuk janë medoemos të motivuara në baza etnike – vazhdojnë të ndikojnë në sigurinë dhe perceptimin për të, duke ndikuar kështu më pas në procesin e kthimit. Është shënuar përparim lidhur Udhëzimet e miratuara rishtazi nga MKK, Ministria për Punë të Brendshme dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, më 18 janar 2018, për reagimet nga mekanizmat e nivelit lokalë ndaj incidenteve që prekin komunitetet. Incidentet vazhdojnë të regjistrohen çdo muaj, kryesisht vjedhje, por përfshijnë edhe sulme, zjarrvënie, incidente me armë zjarri dhe dëmtime të vendeve të trashëgimisë fetare dhe protesta, bllokada të vizitave të pelegrinëve dhe peticione nga komunitetet pritëse kundër kthimit.

Numri i përgjithshëm i kthimeve vullnetare mbetet i kufizuar. Gjatë periudhës së raportimit, numri i përgjithshëm i kthimeve vullnetare ishte 802 në vitin 2015, 582 në vitin 2016, 498 në vitin 2017 dhe 327 në vitin 2018.

Në përputhje me gjetjet e këtij raporti, Misioni në Kosovë i OSBE-së bën thirrje për më tepër përpjekje nga institucionet e Kosovës për të siguruar përparim të konsoliduar dhe më të madh në lidhje me zotimet legjislativë dhe politike për kthim. Misioni në Kosovë i OSBE-së rekomandon veprimet si në vijim: reagim të përmirësuar institucionalë dhe bashkëpunim në të gjitha nivelet e qeverisë; vënia si prioritet me urgjencë e çështjes së dhënies së tokës dhe ofrimit të zgjidhjeve për strehim nga ana e komunës për të kthyerit të cilët nuk kanë tokë; përdorim të zgjeruar të Udhëzimeve të lartcekura të Qeverisë së Kosovës për reagimet nga mekanizmat e nivelit lokalë ndaj incidenteve që prekin komunitetet dhe në përgjithësi shqyrtimi me prioritet i incidenteve që prekin vendet e kthimit, posaçërisht lokacionet më të vogla dhe të izoluara. Po ashtu inkurajohet përkushtimi i pandërprerë ndaj vazhdimit të bashkëpunimit përmes procesit të Shkupit. .

# 1. HYRJE

Në përputhje me mandatin e vet, Misioni i OSBE-së në Kosovë monitoron gjendjen e personave të zhvendosur dhe procesin e kthimit vullnetar, dhe rregullisht raporton për gjetjet e veta. Raporti i kaluar për procesin e kthimit vullnetar është publikuar në vitin 2014 (në tekstin e mëtutjeshëm: raporti i OSBE-së i vitit 2014).<sup>2</sup>

Raporti i OSBE-së i vitit 2014 ka paraqitur progresin e shënuar në gjetjen e zgjidhjeve për zhvendosjet e lidhura me konfliktin dhe për procesin e kthimit, veçanërisht përmes zhvillimit të një kornize të politikave. Në këtë raport, po ashtu, janë paraqitur disa mangësi institucionale, përfshirë funksionimin joadekuat të organeve komunale përgjegjëse për kthim dhe riintegrim të personave të zhvendosur, mungesa e bashkërendimit mes aktorëve qeveritarë dhe komunalë dhe mbledhja e pamjaftueshme e të dhënave dhe menaxhimi i tyre në nivel qeveritar. Raporti më tutje vërejt se çështjet pronësore, incidentet e sigurisë dhe kundërshtimi nga komunitetet pritëse vazhduan ta pengojnë procesin e kthimit, ndërsa bashkëpunimi i pamjaftueshëm mes institucioneve në Kosovë dhe rajon kufizonte efikasitetin e tij.<sup>3</sup>

Ky raport paraqet informata të përditësuara për konstatimet kyçe të raportit të mëparshëm dhe në përgjithësi vlerëson zhvillimet në sferën e kthimeve vullnetare që nga publikimi i tij, posaçërisht *kundruall* respektimit të kornizës së politikave të zbatueshme nga ana e institucioneve gjatë kësaj periudhe të raportimit.

Raporti mbulon periudhën nga janari i vitit 2015 deri në dhjetor të vitit 2018. Megjithatë, periudha raportuese në pjesën e tretë është ndryshuar për të reflektuar ndryshimet në mekanizmat institucionalë të ndërlidhur me kthimin. Në pjesën e parë të tij, mes janarit 2015 dhe dhjetorit 2017, raporti shqyrton obligimet e politikave të institucioneve të ndryshme përgjegjëse për procesin e kthimit dhe respektimi i këtyre detyrimeve nga këto institucione. Ndonëse legjislacioni primar që rregullon procesin e kthimit ishte në fuqi vetëm nga janari 2018 me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Rregullores nr. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme<sup>4</sup> (në tekstin e mëtutjeshëm: Rregullorja për Kthimin), raporti ofron përmbledhje të shkurtër të procesit të hartimit të kësaj Rregulloreje dhe përditësimeve të mëdha pas miratimit të saj. Periudha e tranzicionit mes kornizës së vjetër të politikave dhe kornizës së re ligjore nuk është përfshirë në vlerësim, meqë nuk ka pasur kohe të mjaftueshme për zbatimin e rregullores së re dhe vlerësimin rezultues, që ka rezultuar me mos-përfshirjen e vitit 2018 në pjesën tre të raportit. Në pjesën e katërt paraqiten informata për të drejtat pronësore. Në pjesën e pestë, përkatësisht të gjashtë, raporti hulumton aspektin e sigurisë – sigurinë e të kthyerve në vendet e kthimit dhe kundërshtimin e komuniteteve pritëse ndaj kthimit. Në pjesën e shtatë paraqitet një përmbledhje e bashkëpunimit të shtuar rajonal gjatë periudhës së raportimit, posaçërisht në kuadër të "Nismës ndër-institucionale për

---

<sup>2</sup> Raport i Misionit të OSBE-së në Kosovë "Vlerësim për procesin e kthimit vullnetar në Kosovë", tetor 2014, <https://www.osce.org/kosovo/129321> (qasur më 4 maj 2018).

<sup>3</sup> Po aty, f. 21–22.

<sup>4</sup> MKK, Rregullorja nr. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, miratuar më 4 janar 2018, në dispozicion në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE\\_QRK\) - NR. 01 - 2018 P%3%8BR KTHIMIN E PERSONAVE T%3%8B ZHVENDOSUR DHE ZGJIDHJE T%3%8B Q%3%8BNDRUESHME..pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/RREGULLORE_QRK_-_NR.01_-_2018_P%3%8BR_KTHIMIN_E_PERSONAVE_T%3%8B_ZHVENDOSUR_DHE_ZGJIDHJE_T%3%8B_Q%3%8BNDRUESHME..pdf).



zgjidhjet e qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova”, që njihet gjithashtu si procesi i Shkupit. Raporti përfundon me një numër rekomandimesh për institucionet.

Për sa i përket metodologjisë, raporti, në mënyrë përshkruese, paraqet të dhënat e grumbulluara përmes monitorimit të rregullt dhe të atypëratyshëm nga ana e Misionit të OSBE-së në Kosovë. Të dhënat për punën e institucioneve komunale janë mbledhur dhe përmbledhur dy herë në vit, përmes një vegle monitoruese të standardizuar nga ekipet në terren të Misionit të OSBE-së në Kosovë. Vegla monitoruese në nivel lokal ofron të dhëna statistikore për sigurinë e të kthyerve dhe marrëdhëniet e tyre me komunitetin pritës, dhënien e tokës, zbatimin e projekteve që kanë të bëjnë me kthimin dhe informacion përkitazi me përmbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e komunave për të garantuar të drejtat e personave të zhvendosur dhe të kthyerve.

Të dhënat për punën dhe zhvillimet kryesore brenda Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK) mblidhen për çdo vit nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, gjithashtu përmes një vegle monitoruese. Informatat për incidentet e sigurisë që prekin të kthyerit dhe për rastet e kundërshtimit ndaj kthimit mblidhen në baza të rregullta dhe të atypëratyshme, përmes burimeve të ndryshme nga ana e stafit të Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe ato ruhen në një bazë të brendshme të dhënave të krijuar enkas për këtë qëllim. Të dhënat për numrin e të kthyerve janë marrë nga pasqyrat statistikore të Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR). Informatat për projektet e asistencës për kthim mblidhen nga materialet në dispozicion publik, ose direkt nga aktorët që zbatojnë projektet.

## 2. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Si pasojë e konfliktit të viteve 1998–1999 dhe pas tij, përfshirë trazirat e vitit 2004, përafërsisht 220,000 persona u zhvendosën nga Kosova. Vetëm një pjesë e vogël e tyre është kthyer – 28,111 persona deri në fund të dhjetorit të vitit 2018. Gjatë periudhës aktuale të raportimit, janë kthyer 2,209 persona (1,091 gra dhe 1,118 burra). Megjithatë, shifrat kanë pësuar rënie çdo vit – 802 persona (410 gra, 392 burra) janë kthyer në vitin 2015, 582 (280 gra, 302 burra) në vitin 2016, 498 (247 gra, 251 burra) janë kthyer në vitin 2017 dhe 327 (154 gra dhe 173 burra) në vitin 2018.<sup>5</sup>

Për sa i përket lidhjes me komunitetin, shumica e personave të kthyer gjatë periudhës së raportimit ishin serbë (1,009), pasuar nga egjiptianët (417), romët (357) dhe ashkalitë (218), derisa shqiptarët e Kosovës janë kthyer në komunat ku ata përbëjnë komunitet joshumicë, si Mitrovica e Veriut dhe Zveçan (112). Serbët e Kosovës kryesisht janë kthyer në komunat ku ata përbëjnë një komunitet shumicë si Shtërpca, Graçanica, Novobërda dhe Ranillug, por dukshëm edhe në vende të tjera duke përfshirë Obiliqin, Istogun, Klinë / Klina dhe Gjilani. Për më tepër, romët e Kosovës, ashkalitë dhe egjiptianët e Kosovës kryesisht janë kthyer në komunat ku anëtarë të bashkësive të tyre njihen se kanë banuar tradicionalisht.<sup>6</sup>

Gjatë periudhës së raportimit, procesi i kthimeve u pengua nga çështjet e të drejtave pronësore, incidentet e sigurisë dhe rastet e kundërshtimit të kthimit nga komuniteti pritës, që do të shtjellohen në shumë hollësi në pjesët më poshtë. Zhvillime të rëndësishme që ndodhën gjatë periudhës së raportimit përfshijnë fillimin e ndërtimit të një vendbanimi të madh për të kthyerit, të quajtur “Lugina e Diellit” në Zveçan, në qershor të vitit 2016, protesta në fshatin Mushtisht, Komuna Suharekë, në gusht të vitit 2016 kundër kthimit të serbëve të zhvendosur, kthimi spontan i 13 serbëve në fshatin Lubozhdë, komuna e Istogut, në mars të vitit 2017, ndërsa në 2018 incidentet e sigurisë prekën vizitat në vendet religjioze ortodokse Serbe në Gjakovë, Potërq i Ultë, Klinë dhe në Studenicë, komunë e Istogut.

Projektet kryesore të asistencës për personat e kthyer që janë zbatuar gjatë periudhës së raportimit ishin “Kthimi dhe riintegrimi” (BE-KRK) faza IV dhe V bashkëfinancuar nga MKR dhe Bashkimi Evropian (BE) zbatuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim dhe tre projektet financuar kryesisht nga Departamenti i Shtetit i SHBA-ve, Byroja për Popullsi, Refugjatë dhe Migrim (në tekstin e mëtutjeshëm: BPRM) dhe zbatuar nga Këshilli Danez për Refugjatë (KDR).

IOM zbatoi BE-KRK nga 1 nëntori i vitit 2014 deri më 30 prill të vitit 2017 duke pasur si cak 262 përfitues<sup>7</sup> në komunat Gjilan, Obiliq, Istog, Klinë, Pejë, Suharekë, Shtërpçë dhe Gjakovë, e cila u përfshi më pas në financimin e MKK. Projekti mëtonte sigurimin e asistencës për banim dhe rindërtim të shtëpive, pako të ndihmave, trajnime dhe grante për krijimin e të ardhurave, si dhe projekte të vogla të infrastrukturës për përfituesit e zhvendosur në situata të cënueshme.

<sup>5</sup> UNHCR, Zyra e Shefit të Misionit në Kosovë, pasqyrat statistikore, dhjetor 2018.

<sup>6</sup> Kthim i dukshëm i romeve ka ndodhur në Obiliq, Pejë, Gjilan, Ferizaj dhe Graçanicë; ashkalitë në Ferizaj, Obiliq dhe Fushë Kosovë; dhe egjiptianët në Gjakovë, Pejë dhe Istog.

<sup>7</sup> Gjithsej janë rindërtuar 262 shtëpi, dhjetë projekte infrastrukturore në vendet e kthimit si komponentë balancimi dhe gjashtë projekte të iniciativave të komunitetit, 164 përfitues kanë pranuar pako asistence të harmonizuar (d.m.th. mobile, ushqim, artikuj jo-ushqimor), 243 përfitues morën asistencë socio-ekonomike (që përfshinte shtatë vende pune ndërsa të tjerët pranuan pajisje të nevojshme për gjenerim të të hyrave).

Zbatimi 33 muajsh u financua nga BE me afërsisht 4 milion euro dhe MKK-ja me 2.1 milion euro.<sup>8</sup>

Faza V e të njëjtit projekt filloi të zbatohet më 11 nëntor 2017 dhe ajo synon asistimin e rreth 400 përfituesve në 11 komuna<sup>9</sup> deri më 9 maj 2021. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit BE kontribuoi 8 milion euro, ndërsa fonde nga MKK-së janë 2.75 milion euro.<sup>10</sup> Deri në fund të 2018, BE-KRK V ka përfshirë 120 përfitues.<sup>11</sup>

KDR zbatoi projektin "Riintegrimi dhe stabilizimi i komunitetit në Kosovë" nga 15 shtatori 2014 deri më 14 shtator 2015. Kontributet në vlerë prej afërsisht 371,638 euro nga Departamenti i Shtetit të SHBA, BPRM dhe 88,159<sup>12</sup> euro përmes bashkëfinancimit të OJQ-ve lokale janë dedikuar për kryerjen e riparimeve të vogla të kulmeve, për paketa asistence të harmonizuara dhe grante për gjenerim të të hyrave për 24 familje përfituese gjithandej Kosovës.<sup>13</sup> Veç kësaj, dy fazat e projektit "Përmirësimi i asistencës së kthimit për mundësi të shtuara për zgjidhje të qëndrueshme" u zbatuan nga KDR mes 15 shtatorit 2016 dhe 14 shtatorit 2018, duke pasur si cak gjithsej 150 familje përfituese të cilët morën mbështetje të drejtpërdrejtë dhe përafërsisht 1200 familje përfituese indirekte të ndihmës në Istog, Novobërdë dhe Shtërpçë, Kamenicë, Ranillug dhe Dragash. Dy fazat arritën vlerën e afërsisht 704,413<sup>14</sup> eurove, duke mëtuar "përmirësimin e kapacitetit për të mbështetur integrimin e të kthyerve përmes vlerësimeve të përmirësuara të përqendruara në zgjidhje të qëndrueshme të nevojave që kanë të bëjnë me sfidat e integritit, të përmirësimin e zbatimit të mekanizmave përkrahës ekzistues për integrimin e të kthyerve duke zbatuar qasje të bashkërenduar, gjithëpërfshirëse dhe me shumë aktorë dhe përmirësimin e kushteve themelore të jetesës së të kthyerve më të cënueshëm përmes riparimeve të vogla të vendstrehimeve dhe nxitjes së integritit të komunitetit dhe kohezionit shumetnik përmes granteve të përbashkëta rurale për krijimin e të ardhurave." Përfundimisht, KDR nisi projektin "Promovimi i programimit të zgjidhjeve të qëndrueshme të bazuara në prova në Kosovë" me vlerë afërsisht 176,120<sup>15</sup> euro në fund të periudhës së raportimit, në shtator 2018. Përmes këtij projekti, KDR synon të asistojë 39 familje përfituese në Gjilan, Prizren dhe Klinë përmes asistencës të bazuar në nevoja, si në projektet e shkuara.<sup>16</sup>

Përfundimisht, krahas projekteve të ndihmës për të kthyerit të siguruara me kontributin e MKK-së siç u shpjegua më lart, gjatë periudhës raportuese MKK ka investuar në projekte që mbështesin kthimin dhe riintegrimin. Në vitin 2015, Qeveria e Kosovës ka ndarë buxhet prej 7,900,896 euro për MKK-në, nga të cilat 6,592,626 Euro për investime kapitale, duke përfshirë mbështetjen për kthimin dhe riintegrimin.<sup>17</sup> Në vitin 2016, Qeveria e Kosovës miratoi buxhet

<sup>8</sup> IOM Kosovë, BE-Kthimi dhe riintegrimi në Kosovë, në dispozicion në <http://kosovo.iom.int/eu-return-reintegration-kosovo>.

<sup>9</sup> Pejë, Klinë, Istog, Obiliq, Fushë Kosovë, Graçanicë, Novobërdë, Kamenicë, Shtërpçë, Prizren, Rahovec. IOM Kosovë, EU-RRK Projekti V Fletë-informuese, në dispozicion në: <http://kosovo.iom.int/sites/default/files/IOM%20%20EU%20RRK%20V%20Project%20fact%20sheet%20Nov%202017%20%20ENG.pdf>.

<sup>10</sup> Informacion i siguruar nga IOM, 19 shkurt 2019.

<sup>11</sup> 103 shtëpi të rindërtuara, 86 përfitues kanë pranuar mobile dhe pajisje shtëpiake, 78 kanë marrë ushqim dhe artikuj ushqimor, 67 kanë marrë dru zjarri dhe 29 kanë marrë asistencë socio-ekonomike (nga e cila 26 grante për gjenerim të të hyrave dhe katër vende pune të siguruara).

<sup>12</sup> Shuma origjinale e ndarë 421,835 dollarë dhe 100,067 dollarë, respektivisht.

<sup>13</sup> Informacion i siguruar nga KDR, 25 shkurt 2019.

<sup>14</sup> Gjithsej 799,793 dollarë.

<sup>15</sup> Gjithsej 199,968 dollarë.

<sup>16</sup> Po aty.

<sup>17</sup> Auditori i Përgjithshëm, Raporti financiar për Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthimit 2015, <http://zka-rks.org/wp-content/uploads/2017/06/RaportiAuditimit.MKK.2015.Shqip.192470.pdf>.

total prej 7,678,008 Euro për MKK-në. Gjatë vitit në fjalë, buxheti u rrit me 944,632 euro për të mbështetur projektet në Mitrovicën e Veriut.<sup>18</sup> Në vitin 2017 MKK ka buxhetuar 4,631,607 euro, nga të cilat 3,160,000 janë ndarë për të mbështetur investimet kapitale, duke përfshirë mbështetjen për kthim dhe riintegrim. Në formën e subvencioneve, MKK-ja ka ndarë 290,000 euro për OJQ-të në mbështetje të integritimit dhe asistencës për komunitetet.<sup>19</sup> Për vitin 2018, MKK ka marrë shumën e ndarë prej 8,387,806 euro, në të cilën përfshihet ndërtimi i banesave siç tregohet më sipër dhe 3,500,000 euro për projekte që përfshijnë komunitetet.<sup>20</sup>

Mbështetja në projektet e financuara nga donatorët për zgjidhjet e banimit për të kthyerit është problematike; posaçërisht duke qenë se vetëm një numër i vogël komunash participojnë dhe të kthyerit e mundshëm nga komunat tjera duhet të mbështeten në asistencën sporadike nga MKR. Kjo është çështje e rëndësishme në komunat ku duan të kthehen një numër më i madh i personave të zhvendosur. Disa komuna, si ajo e Graçanicës apo e Kamenicës u përfshinë në fazën pasuese të projektit (BE-KRK V) që filloi kah fundi i vitit 2017. Komunat tjera, si Dragashi, Ferizaj, Gjakova apo Lipjani, nuk u përfshinë.<sup>21</sup> Për më tepër, të kthyerit e mundshëm në këto komuna shpeshherë janë pjesëtarë të cënueshëm të komuniteteve romë, ashkali, egjiptianë apo goranë të cilëve u duhet ndihmë e konsiderueshme për kthim. Prandaj, MKR, teoritikisht, do të duhej të ishte në gjendje që të siguronte ndihmë në mënyrë të paanshme për kthim në të gjitha komunat e Kosovës, për të gjithë personat e zhvendosur të cilët janë të interesuar për t'u kthyer, gjersa u jep prioritet personave të cënueshëm dhe personave të cilët janë të zhvendosur që një kohë të gjatë.

---

<sup>18</sup> Auditori i Përgjithshëm, Raporti i auditimit financiar për Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthimit 2016, <http://zka-rks.org/wp-content/uploads/2017/07/RaportiAuditimit.MKK.2016.Shqip.587412.pdf>, nxjerrë në qershor 2017.

<sup>19</sup> Auditori i Përgjithshëm, Raporti i auditimit financiar për Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthimit 2017, [http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/06/RaportiAuditimit\\_MKK\\_2017\\_Shqip.pdf](http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2018/06/RaportiAuditimit_MKK_2017_Shqip.pdf), nxjerrë në qershor 2018.

<sup>20</sup> Ministria e Financave, raporti financiar nëntëmuor për periudhën 1 janar – 30 shtator 2018, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/E57FE42C-81E2-4C6D-8DC1-E690CF83839D.pdf>.

<sup>21</sup> Shifrat për interesimin për t'u kthyer u morën nga: Zyra rajonale e UNHCR për Evropën Juglindore, personat e zhvendosur nga Kosova në rajon – një rivlerësim i interesimit për t'u kthyer, në dispozicion në: [http://www.unhcr.org/see/wp-content/uploads/sites/57/2018/05/UNHCR\\_KOS\\_Needs-Assessment-Report\\_NA\\_English.pdf](http://www.unhcr.org/see/wp-content/uploads/sites/57/2018/05/UNHCR_KOS_Needs-Assessment-Report_NA_English.pdf), f. 33.

### 3. ZBATIMI I KORNIZËS LIGJORE DHE TË POLITIKAVE

E drejta e personave të zhvendosur për t'u kthyer në shtëpitë e tyre me siguri dhe dinjitet dhe për t'i rikthyer pronat dhe posedimet e tyre është e mishëruar si në kornizën ligjore të Kosovës ashtu dhe në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë.<sup>22</sup> Këto të drejta janë të lidhura ngushtë me tri të drejta themelore të njeriut: lirinë e lëvizjes, gëzimin paqësor të pasurisë dhe respektimin e jetës private dhe familjare.<sup>23</sup> Institucionet kanë obligimin për të krijuar kushte dhe për të siguruar mjete të nevojshme për t'ju lejuar personave të zhvendosur të kthehen në shtëpitë e tyre, në mënyrë të sigurt dhe të dinjitetshme, për të marrë pjesë plotësisht në planifikimin dhe menaxhimin e kthimit të tyre dhe riintegrimin, si dhe për të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në çështjet publike dhe të gëzojnë qasje të barabartë në shërbimet publike.<sup>24</sup>

#### 3.1 Korniza ligjore e Kosovës

Ndonëse miratimi shumë i rëndësishëm i legjislacionit të parë që synon rregullimin e procesit të kthimit është përshkruar në nën-pjesën 3.3 më poshtë, deri në janar 2018.

Korniza ligjore përmbante vetëm dispozita të përgjithshme që riafirmojnë të drejtën për kthim në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Kjo vërehet dukshëm në nenin 156 të Kushtetutës: "[...] Kosova promovon dhe lehtëson kthimin e sigurt dhe me dinjitet të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit, dhe u ndihmon atyre për kthimin e pronave dhe posedimeve të tyre."<sup>25</sup> Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre nuk cek shprehimisht të drejtën për kthim; sidoqoftë, disa dispozita që kanë të bëjnë me sigurinë, të drejtat gjuhësore, arsimin, pjesëmarrjen publike dhe mundësitë sociale dhe ekonomike kanë ndikim të drejtpërdrejtë në riintegrimin e qëndrueshëm të të kthyerve.<sup>26</sup>

Legjislacioni më i detajuar në fuqi gjatë periudhës së raportimit, që ka të bëjë me procesin e kthimit, është Rregullorja nr. 02/2010 (Rregullorja për ZKKK), për themelimin e zyrave komunale për komunitete dhe kthim e që ka përcaktuar përgjegjësitë e tyre.<sup>27</sup> Rregullorja për ZKKK shprehimisht i jep mandatin ZKKK që të "bashkërendojë procesin e kthimit dhe të promovojë krijimin e kushteve për kthimin dhe riintegrimin e personave të zhvendosur dhe të

<sup>22</sup> Neni 13.2 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut; Neni 12.4 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Neni 5.d.ii i Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor. Neni 22 i Kushtetutës përcakton që këto instrumente janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në Kosovë. Përveç këtyre, sfera e kësaj të drejte është më tej e shtjelluar në: Parimet Udhëzuese për Zhvendosjet e Brendshme (E/CN.4/1998/53/Add.2), 11 shkurt 1998; Parimet për Banimin dhe Rikthimin e Pronës për Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur (E/CN.4/Sub.2/2005/17), 11 gusht 2005 ("Parimet e Pinheiro-s") si dhe Njëzetë Udhëzimet e Këshillit të Evropës (KE) për Kthimin me Forcë, shtator 2005 (Udhëzimet e KE").

<sup>23</sup> KEDNJ, ETS 5, botuar më 4 nëntor 1950, Protokollin 4, neni 2; Protokollin 1, neni 1 dhe neni 8. Në dispozicion në: <http://www.unhcr.org/refworld/docid/3ae6b3b04.html> (qasur më 19 dhjetor 2017).

<sup>24</sup> Këshilli Ekonomik dhe Social, E/CN.4/Sub.2/2005/17, 28 qershor 2005, Shtojca.

<sup>25</sup> Neni 156 i Kushtetutës.

<sup>26</sup> Nenet 1, 2, 4, 8, 9, 11 të Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre ([http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L047\\_en.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L047_en.pdf)).

<sup>27</sup> Zyra e Kryeministrit, Rregullorja nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, miratuar më 12 gusht 2010; në dispozicion në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullore\\_per\\_Zyrat\\_komunale\\_per\\_Komunitete\\_dhe\\_Kthim.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullore_per_Zyrat_komunale_per_Komunitete_dhe_Kthim.pdf).

riatdhesuar në komunë.<sup>28</sup> Sa i përket kthimeve, ZKKK përgatit plane të veprimit përkatëse për t'i ndihmuar komunës në përmbushjen e obligimeve të veta në lidhje me procesin e kthimit,<sup>29</sup> i dorëzon raporte të rregullta udhëheqjes komunale mbi përparimin e shënuar në procesin e kthimit<sup>30</sup> dhe mirëmban bazën e të dhënave elektronike për personat e zhvendosur dhe të kthyerit vullnetar.<sup>31</sup> Këto detyrime, megjithatë, nuk u ndërlidhën me ndonjë kornizë ligjore gjithëpërfshirëse që rregullon procesin e kthimit, deri në miratimin e Rregullores për Kthim më 15 janar 2018.

## 3.2 Korniza e politikave e Kosovës

Dokument kyç i politikave që rregullon procesin e kthimit është Doracaku i rishikuar i UNMIK-ut për kthim të qëndrueshëm i vitit 2006 (më tekstin e mëtejme Doracaku).<sup>32</sup> Doracaku përkufizon rolet dhe përgjegjësitë e gjitha institucioneve përkatëse në nivel të qeverisë dhe në nivel komunal në secilën fazë të procesit të kthimit.<sup>33</sup> Gjithashtu, ai përcakton parimet themelore udhëzuese për procesin e kthimit vullnetar. Kthimi duhet të jetë i bazuar në të drejta, të jetë i qëndrueshëm, nga poshtë-lartë, të jetë i nxitur nga personat e zhvendosur, dhe të jetë pjesëmarrës, duhet të angazhojë tërë komunitetin, ndërsa kthimi në vendin e prejardhjes duhet të jetë opsion i parë.<sup>34</sup> Doracaku përcakton formimin e grupeve punuese komunale për kthim (GPKK)<sup>35</sup> dhe Mekanizmin shqyrtues qendror (MSHQ)<sup>36</sup>, si mekanizma kryesorë për bashkërendim në nivel të komunave dhe të qeverisë, përkatësisht.

Doracaku u plotësua më pas me Udhëzimet e MKK-së për zbatimin e përkrahjes për kthim të vitit 2012 (Udhëzimet) me qëllim të mundësisimit "të përcjelljes efikase të kërkesave për ndihmë dhe ofrim transparent dhe të paanshëm të përkrahjes."<sup>37</sup> Udhëzimet i centralizojnë përgjegjësitë për bashkërendim në duart e MKK-së dhe përgjegjësitë për vendimmarrje mbi ofrimin e ndihmës tek Komisioni Shqyrtues Qendror (KSHQ) që udhëhiqet nga MKK.<sup>38</sup> Në nivel komunal, udhëzimet e njohin rolin e ZKKK-ve dhe të njëjtave u japin përgjegjësi të shtuara veç atyre të përvijuara në Rregulloren për ZKKK-të. Gjithashtu, udhëzimet formojnë taskforcën komunale për kthim (Task forca) nën udhëheqjen e ZKKK-së, si trupë punuese në nivel të komunave.

Korniza e politikave e Kosovës ka qenë formalisht në fuqi deri në miratimin e Rregullores për Kthim në janar 2018 (të përshkruara në nën-pjesën 3.3 më poshtë), e cila tani përbën kuadrin ligjorisht detyrues.

<sup>28</sup> Neni 7(1.3) i Rregullores për ZKKK.

<sup>29</sup> Po aty, neni 7(1.4).

<sup>30</sup> Po aty, neni (1.7).

<sup>31</sup> Po aty, neni 7(2).

<sup>32</sup> Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë/Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (IPVQ), Doracaku i ripunuar për kthim të qëndrueshëm, korrik 2006.

<sup>33</sup> f. 18-27, po aty.

<sup>34</sup> f. 8-9, po aty.

<sup>35</sup> f. 13-14, po aty.

<sup>36</sup> f. 15-16, po aty.

<sup>37</sup> f. 1, MKK, Udhëzimet për zbatimin e përkrahjes për kthim, 27 mars 2012.

<sup>38</sup> f. 5, Udhëzimet.

Përfundimisht, në shkurt të vitit 2014, MKK-ja miratoi Strategjinë e ripërtëritur për komunitete dhe kthim për periudhën 2014-2018 dhe planin gjegjës të veprimit.<sup>39</sup> Strategjia përvijon katër objektiva strategjike kryesore: 1) kthimi i qëndrueshëm i personave të zhvendosur brenda vendit dhe personave të zhvendosur në shtetet e rajonit; 2) fuqizimi dhe stabilizimi i komuniteteve në Kosovë; 3) hartimi dhe plotësimi i kornizës ligjore për komunitete, kthim dhe riintegrim; 4) avancimi i sistemit të menaxhimit të brendshëm të MKK-së. Në shërbim të përmbushjes së objektivave strategjike janë propozuar disa masa, duke përfshirë këtu ofrimin e ndihmës për personat e zhvendosur që jetojnë në qendrat kolektive dhe vendbanimet private, bashkërendimin për qëllime të ndarjes së tokës, forcimin e mekanizmave të informimit, përmirësimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit mes mekanizmave, mbështetjen për kthim të qëndrueshëm dhe zhvillim ekonomik, ndryshimin dhe plotësimin e kornizës ligjore për kthim, dhe krijimin e një sistemi funksional dhe azhur të menaxhimit të të dhënave.<sup>40</sup> Raporti i OSBE-së i vitit 2014 i kishte mirëpritur shumë nga zhvillimet e sipërpërmendura, por kishte kritikuar njëherazi mungesën e hollësive për masat specifike dhe afatet korresponduese kohore dhe burimeve të nevojshme njerëzore e financiare të nevojshme për zbatimin e Strategjisë dhe planit gjegjës të veprimit.<sup>41</sup>

### 3.3 Drejt një rregulloreje për kthimin

Duke qenë të vetëdijshëm për mungesën e legjislacionit gjithëpërfshirës me të cilin do të rregullohej procesi i kthimit, dhe duke pasur parasysh rekomandimet e Misionit të OSBE-së në Kosovë në raportin e vitit 2014 dhe përkushtimin e shprehur në Strategjinë për komunitete dhe kthim 2014–2018, MKK-ja, me përkrahje nga Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe UNHCR filloi së hartuari rregulloren për kthimin e personave të zhvendosur në vitin 2015. U formua grupi përkatës i punës dhe u arrit pajtimi që i njëjti të hartojë rregulloren me të cilën do të përcaktohej kuadri dhe procedura gjithëpërfshirëse institucionale për t'i ndihmuar personat e zhvendosur në kthim dhe riintegrim. Rregullorja duhej të përfshinte përkufizimet e kriterëve dhe prioritizimit për cenueshmërinë, më shumë lloje të pakove të ndihmave, menaxhimin e të dhënave, përgjegjësitë e mekanizmave qeveritarë dhe komunalë, si dhe monitorimin e raportimin. Me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe UNHCR-së, u mbajtën dy punëtori për hartimin e rregullores, njëra në Shkup (20–21 dhjetor 2015) dhe tjetra në Tiranë (6–10 prill 2016), dhe më 9 gusht 2016 Projektregullorja u procedua nga MKK për konsultime publike. Megjithatë, zhvillimet politike sikurse ishte pezullimi i pjesëmarrjes së partisë politike "Lista Serbe" nga qeveria në pjesën e fundit të vitit 2016, dhe periudha e bllokadave politike në Kuvendin e Kosovës që i parapriu dhe e përcolli shpërbërjen e qeverisë dhe zgjedhjet pasuese në vitin 2017 shkaktuan vonesa të konsiderueshme në miratimin e Rregullores. Rregullorja për kthim<sup>42</sup> u miratua përfundimisht nga qeveria më 15 janar 2018.

Rregullorja e re është hap i madh drejt konsolidimit të procedurave dhe bashkërendimit ndërmjet mekanizmave të ndryshëm që janë aktivë në procesin e kthimit. Struktura e mëhershme e GPKK-ve dhe task forcave shfuqizohet dhe zëvendësohet me komision të ri komunal për kthim (KKK).<sup>43</sup> Rregullorja e forcon rolin e MKK-së për mbikëqyrje dhe kërkim

<sup>39</sup> MKK, Strategjia për komunitete dhe kthim 2014–2018, dhjetor 2013, [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGY\\_FOR\\_COMMUNITIES\\_AND\\_RETURN\\_2014-2018.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGY_FOR_COMMUNITIES_AND_RETURN_2014-2018.pdf).

<sup>40</sup> f. 19-22, Strategjia.

<sup>41</sup> f. 9, Raporti i OSBE-së i vitit 2014, *shënimi 2 më sipër*.

<sup>42</sup> MKK, Rregullorja nr. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, *shënimi 4 më sipër*.

<sup>43</sup> Neni 24, po aty.

llogarie në lidhje me punën e institucioneve në nivel komunal dhe parasheh emërimin e koordinatorëve rajonalë për të siguruar rrjedhë më të mirë të informatave ndërmjet MKK-së dhe ZKKK-ve.<sup>44</sup> Veç kësaj, për të shtuar llogaridhënien nga ana e Komisionit Qendror Shqyrtues si organ vendimmarrës, duhet të themelohet dhe një komision për ankesa.<sup>45</sup> Në fund, Rregullorja mandaton përzgjedhjen e përfituesve vetëm mbi baza të nevojave, sipas një liste të kriterëve të cënueshmërisë që janë përpiluar për të shërbyer si orientim në prioritizimin e rasteve.<sup>46</sup> Ajo përfshin obligimin e komunave dhe të MKK për të siguruar asistencë për të gjithë aplikuesit e kualifikuar, por u jep prioritet rasteve të cënueshme përmes disa kriterëve. Nga aspekti negativ, Rregullorja kufizon efektshmërinë e ndihmës për nevojat e menjëhershme, meqë kompetenca e vendimmarrjes për ofrimin e pakove të ndihmës për nevoja urgjente i është dhënë MKK-së në vend se komunave. Po ashtu, Rregullorja ia lë kompetencën për përzgjedhjen përfundimtare të përfituesve Komisionit Qendror Shqyrtues, me mundësi të përbërjes së këtij organi ekskluzivisht vetëm nga përfaqësues të MKK-së, e që mund të ndikojë negativisht në transparencën e procesit të vendimmarrjes. Sidoqoftë, krijimi i bazës ligjore për procesin e kthimit është një zhvillim domethënës.

Që nga miratimi i Rregullores për kthim, themelimi i mekanizmave të sipërpërmendur është shtyrë deri në finalizimin e Udhëzuesit për zbatimin e Rregullores<sup>47</sup> në tetor 2018. Gjatë 2018, Misioni i OSBE-së, UNHCR dhe IOM kanë përkrahur MKK përmes hartimit të Udhëzuesit. Ky dokument përkrahës, i shoqëruar me një seri shtojcash, i sqaron procedurat lidhur me aplikim për asistencë në kthim, vlerësim të aplikantëve dhe ofrimin e ndihmës për përfituesit, dhe shkon tutje në sqarimin e rolit të çdo hisedari të përfshirë, në veçanti ZKKK si hisedar udhëheqës i nivelit lokal në procesin e kthimit. Pas miratimit të Rregullores për kthim, 20 Komisione Komunale për Kthim janë themeluar gjithandej Kosovës deri në fund të periudhës së raportimit. Pavarësisht këtij zhvilli pozitiv, këto komisione nuk kanë qenë funksionale në vitin 2018 meqë Udhëzuesi ende nuk ishte miratuar. Në vend të kësaj, mekanizmat e mëparshëm të dalë nga korniza e politikave (GPKK dhe Task Forcat për Kthimet) kanë vazhduar me procedimin e aplikacioneve gjatë kësaj periudhe. Veç kësaj, mekanizmat e nivelit qeveritar siç përcaktohet me Rregulloren e re nuk janë themeluar deri në fund të vitit 2018.

Meqë korniza e re ligjore nuk ishte funksionale gjatë periudhës së raportimit, nën-pjesët në vazhdim shtjellojnë formimin dhe funksionimin e mekanizmave përgjegjës për zbatimin e ndihmës për kthim dhe riintegrim në nivel lokal sipas kornizës së politikave, gjegjësisht të ZKKK-ve, GPKK-ve dhe Task forcave për kthimin. Të njëjtat nën-pjesë shtjellojnë po ashtu edhe miratimin dhe zbatimin e strategjive komunale për kthim.

---

<sup>44</sup> Neni 5(6), po aty.

<sup>45</sup> Neni 26, po aty.

<sup>46</sup> Neni 10, po aty.

<sup>47</sup> MKK, Udhëzuesi për zbatimin e Rregullores (QRK) – Nr. 02/2018 për Kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, në dispozicion: <http://mzp-rks.org/en/images/dokumenta/uputstvoen.pdf>.



## 3.4 Funksionimi i mekanizmave të kornizës së politikave

### *Zyrat komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK)*

ZKKK është mekanizmi me bazën më të hollësishme ligjore, të hartuar falë bashkëpunimit ndërmjet organeve qendrore të ndryshme që kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për çështjet e komuniteteve,<sup>48</sup> si edhe disa hisedarëve ndërkombëtarë.

Si mekanizma kryesorë me përgjegjësi të zbatimit në praktikë të përkrahjes për kthim,<sup>49</sup> ZKKK-të janë organe të rëndësishme thelbësore. Komunitetet kanë detyrimin që t'i themelojnë zyrtarisht këto zyra dhe të sigurojnë se ato kanë kuadro të duhur dhe se janë funksionale.<sup>50</sup> Vlerësimet në terren të Misionit të OSBE-së në Kosovë tregojnë se deri në dhjetor 2018, ZKKK-të janë themeluar në 35 komuna.<sup>51</sup>

Rregullorja për ZKKK është me rëndësi domethënëse në kuptim të ngritjes së ZKKK-së si mekanizëm unik për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve, duke inkorporuar ish-zyrat komunale për komunitetet dhe zyrat komunale për kthim. Dokumenti i politikave "Termet e referencës - Procedurat Standarde të Veprimit për ZKKK"<sup>52</sup> (TeR) jep udhëzime shtesë, duke i përcaktuar në hollësi përgjegjësitë specifike të ZKKK në tri fusha të të drejtave të komuniteteve: qasja në shërbime, kthimi dhe riatdhesimi.

Të dhënat nga monitorimi i Misionit të OSBE-së në Kosovë janë shfrytëzuar për ta rishikuar funksionimin e ZKKK-ve gjatë periudhës së raportimit në lidhje me tri detyra kryesore që burojnë nga Rregullorja për ZKKK dhe TeR: i) informimi dhe vlerësimi i nevojave, ii) mundësimi i vizitave shko-dhe-shih (VSHSH) dhe vizitave shko-dhe-informohu (VSHI), iii) realizimi i aktiviteteve/projekteve në përkrahje të kthimit (po ashtu duke iu referuar aktiviteteve që janë ndërmarrë nga organizatat e tjera).

Sipas Rregullores për ZKKK, një nga përgjegjësitë kryesore të ZKKK-së është monitorimi i gjendjes së personave të zhvendosur dhe të kthyerve të cilët jetojnë në komunitet e tyre, duke kontaktuar me ta dhe vlerësuar nevojat e tyre dhe në bazë të këtyre nevojave të ofrojnë ndihmë. Nga 35 ZKKK-të që iu nënshtruan vlerësimit, 19 sosh kanë realizuar vizita kontaktuese të kthyerit ose personat e zhvendosur për t'i vlerësuar nevojat dhe për të ofruar informata, duke shënuar rritje në krahësim me periudhën paraprake të raportimit.<sup>53</sup> Nga këto, tri ZKKK kanë realizuar vizita kontaktuese vetëm një herë gjatë periudhës së raportimit,<sup>54</sup> ndërsa një

<sup>48</sup> Ministria për Komunitete dhe Kthim, Zyra për Çështje të Komuniteteve, Ministria e Administrimit Publik, Ministria e Punëve të Brendshme, si dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

<sup>49</sup> Ky mekanizëm ka bazën ligjore më të hollësishme për sa i përket kthimit. Siç është përcaktuar në Udhëzimet për zbatimin e përkrahjes për kthim, ZKKK-të janë "organi kryesor për përkrahjen e personave të cilët kthehen në Kosovë."

<sup>50</sup> Rregullorja për ZKKK, nenet 1, 5 dhe 10, *shënimi 26 më sipër*.

<sup>51</sup> ZKKK nuk është themeluar në komunitet e Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Mitrovicës Veriore, ndonëse ato kanë ruajtur strukturat e UNMIK-ut për komunitetet, pra Zyrën Komunale për Komunitete (ZKK) që kryen disa detyra të ZKKK duke përfshirë këtu ato që kanë të bëjnë me kthimin. Vlerësimi i mbulon të gjitha komunitetet në Kosovë përkatësi me funksionet kyçe në përkrahje të kthimit.

<sup>52</sup> Termet e referencës - Procedurat standarde të veprimit për ZKKK, të miratuara nga Grupi punues ndërmintor për ZKKK dhe të publikuara më 21 prill 2011, në dispozicion tek:

[http://www.zck-ks.net/repository/docs/ToR\\_for\\_MOCRs-20110421-final-eng.pdf](http://www.zck-ks.net/repository/docs/ToR_for_MOCRs-20110421-final-eng.pdf)

<sup>53</sup> Prej vitit 2012 deri në 2014, vetëm 11 ZKKK kishin ndërmarrë vizita kontaktuese.

<sup>54</sup> Në Leposaviq, Mitrovicë Veriore dhe Shtime.

tjetër është organizuar me përkrahjen e një organizate ndërkombëtare.<sup>55</sup> Vizitat në fjalë janë realizuar për qëllime të ndryshme, duke filluar nga vlerësimi i pronave të personave të zhvendosur të cilët kanë shprehur dëshirën të kthehen, vlerësimi i nevojave të tyre, vlerësimi i riintegrit të tyre, duke përfshirë edhe vizitat që në qendra kolektive.

Sipas gjetjeve nga monitorimi i Misionit të OSBE-së në Kosovë, 12 ZKKK<sup>56</sup> kanë organizuar VSHSH dhe VSHI rregullisht, qoftë në mënyrë të pavarur ose bashkërisht me organizata donatore,<sup>57</sup> e që paraqet regres krahasuar me periudhën e mëparshme të raportimit.<sup>58</sup> Sa u përket projekteve, vetëm disa ZKKK e kanë përbushur detyrën për të hartuar, zbatuar dhe monitoruar projekte për avancimin e të drejtave të komuniteteve për të gëzuar qasje në shërbimet publike dhe për të përkrahur kushtet për kthim dhe riintegrim të qëndrueshëm.<sup>59</sup> Shembuj pozitivë kanë dhënë ZKKK-ja në Novobërdë me hartimin e një projekti për sigurimin e pajisjeve për qendrën për komunitete të kësaj komune,<sup>60</sup> Kamenica me përkrahjen për vendin e kthimit të romëve të Kosovës në Berivojcë duke bërë pastrimin e gropave septike, dhe Podujeva me shtrimin e trotuareve në fshatin Metrgovc. Llojet e tjera të ndihmës kanë përfshirë donacione të vogla të artikujve ushqimorë dhe joushqimorë, sidomos në komunën e Istogut dhe Klinës. Megjithatë, shikuar përgjithësisht, vazhdon trendi i ofrimit të ndihmës nga ZKKK-të përmes projekteve të financuara nga donatorët.

### **Grupet punuese komunale për kthim (GPKK) dhe task forcat komunale për kthim (task forcat)**

Përgjegjësi parësore e GPKK-së është të bashkërendojë dhe zbatojë të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me kthimin në komunë dhe ta promovojë komunikimin midis personave të zhvendosur personave të zhvendosur dhe komunitetit të tyre amë.<sup>61</sup> GPKK kryesohet nga kryetari i komunës dhe duhet të mbledhet një herë në muaj. Në përbërjen e vet ka pjesëtarë të komuniteteve pritëse dhe atyre që kthehen, institucione dhe organizata ndërkombëtare përkatëse. Deri në fund të 2017, vlerësimet në terren të bëra nga Misioni i OSBE-së në Kosovë vënë në dukje se nga 38 komuna, GPKK-të janë themeluar në 28 sosh.<sup>62</sup>

Task forcat organizohen dhe udhëhiqen nga ZKKK-ja, dhe roli parësor i tyre është ta mbështesin GPKK-në në punën e tij me vlerësimin dhe shqyrtimin e kërkesave individuale të personave të zhvendosur për ndihmë. Task forcat përbëhen nga koordinatorët dhe zyrtarët komunalë për kthim, përfaqësuesi i MKK-së, UNHCR-së dhe, ashtu siç është paraparë nga Udhëzuesi<sup>63</sup>, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare apo OJQ-ve përkatëse që janë partnerë. Krahasuar me periudhën paraprake të raportimit gjatë së cilës ishin themeluar 21 task forca, gjatë kësaj periudhe të raportimit numri i task forcave është rritur në 32 nga gjithsej 38 komuna. Nga numri total i task forcave të themeluara 31 janë vlerësuar si përgjithësisht funksionale. Task forca e Podujevës është vlerësuar si pjesërisht funksionale, meqë është mbledhur vetëm tri herë gjatë kësaj periudhe të raportimit dhe, për rrjedhojë, nuk po e

<sup>55</sup> Skenderaj, përmes UNHCR-it dhe OJQ "Advancing Together".

<sup>56</sup> Gjilan, Kamenicë, Ranillug, Viti, Mitrovicë Jugore, Deçan, Istog, Klinë, Pejë, Fushë Kosovë, Obiliq dhe Prizren.

<sup>57</sup> Me DRC dhe IOM.

<sup>58</sup> Gjithsej 18 sosh kanë realizuar VSHSH/VSHI.

<sup>59</sup> Rregullorja për ZKKK-të, neni 7(1.7), shënimi 27 më sipër.

<sup>60</sup> Projekti është financuar nga UNMIK-u.

<sup>61</sup> f. 13–14, Doracaku, shënimi 32 më sipër.

<sup>62</sup> Ky numër ka mbetur i njëjtë sikundër në periudhën e mëparshme të raportimit 2012–2014.

<sup>63</sup> Pjesa 4 dhe 5, Udhëzuesi, shënim 37 më sipër.

përkrahë në mënyrë proaktive procesin e kthimit. Task forcat punojnë kryesisht me projekte dhe përqendrohen në vlerësimet e bëra para kthimit dhe zbatimin e ndihmave.

Sipas monitorimeve të Misionit të OSBE-së në Kosovë, shpeshtësia e takimeve të të dyja organeve është më e ulët se që parashihet me detyrimet e politikave. GPKK-të nuk mblidhen çdo muaj siç parashihet në Doracak, gjersa vetëm disa task forca mblidhen brenda dy javëve nga data e pranimit të kërkesës për ta bërë vlerësimin e nevojave.<sup>64</sup> Krahasuar me tjerat, task forcat në Klinë, Prizren, Istog dhe Pejë i përmbushin këto detyrime më së shumti dhe i realizojnë detyrimet e tyre që burojnë nga politikat brenda periudhës së paraparë.


Në realitet, dy organet lokale (GPKK dhe task forca) kanë dyfishim funksionesh, ndërsa praktika e tyre e punës është e ndryshme nëpër komuna të ndryshme të Kosovës. Për shembull, në disa komuna task forca bën shqyrtimin fillestar të kërkesave, ia procedon ato GPKK-së për miratim paraprak dhe më pas GPKK-ja ia procedon kërkesat me rekomandim për miratim përfundimtar Komisionit Qendror Shqyrtues. Në komunat e tjera si Istogu, Klina, Peja apo Shtërpca, task forcat ia dërgonin shpesh kërkesat KQSH-së pa i shqyrtuar fare. KQSH merr gjithmonë vendimin përfundimtar përkitazi me përzgjedhjen e përfituesve.

Monitorimi i Misionit të OSBE-së në Kosovë vë në dukje se gjatë periudhës për të cilën raportohet të dy mekanizmat janë mbledhur vetëm për qëllime të lehtësimit të projekteve të financuara nga BE-ja dhe të programit RRR të zbatuar nga IOM-i. Kjo paraqet ngecje në përmbushjen e detyrimeve të tyre për të diskutuar rreth ofrimit të ndihmave tjera përveçse përmes donacioneve në dispozicion. Monitorimi i Misionit të OSBE-së në Kosovë ka vërejtur hendek të madh mes numrit të rasteve të shqyrtuara nga të dyja organet dhe numrit të kërkesave të miratuara apo rekomanduara (shih grafikonet 1 dhe 2 më poshtë). Kjo gjë ka qenë e dukshme sidomos gjatë vitit 2016 dhe 2017, ku GPKK-të kanë miratuar më pak se gjysmën e rasteve në shqyrtim, derisa task forcat kanë rekomanduar më pak se një të tretën e gjitha rasteve që i kanë shqyrtuar. Sipas monitorimeve të Misionit të OSBE-së në Kosovë, problemet kryesore kanë qenë dokumentacioni i pamjaftueshëm i ofruar, mospasja e tokës në pronësi ose mosdhënia e tokës në shfrytëzim nga komuna, varësia e plotë nga financimi përmes projekteve apo zbatimi i pavend i kornizës së politikave nga secili prej dy mekanizmave siç tregohet më sipër.

---


<sup>64</sup> Po aty.

## Mbledhjet e grupit punues komunal në mbarë vendin



Grafiku 2: Mbledhjet e task forcave në mbarë vendin gjatë periudhës 2015–2017<sup>65</sup>

## Task forcat - Mbledhjet e mbajtura në mbarë vendin



Grafiku 2: Mbledhjet e task forcave në mbarë vendin gjatë periudhës 2015–2017<sup>66</sup>

<sup>65</sup> Siç është shpjeguar në nën-seksionin 3.3, GPKK nuk janë vlerësuar në vitin 2018 pasi mekanizmat e rinj me detyrim ligjor janë krijuar zyrtarisht. Me miratimin e Rregullores së re në Janar 2018, u krijuan mekanizma të rinj të nivelit lokal (Komisionet Komunale për Kthim) ndërsa mekanizmat e vjetër të kornizës së politikave (GPKK dhe Task Forca) u shfuqizuan. Në vitin 2018 ishin duke u krijuar Komisionet Komunale për Kthim, kështu që funksionimi i rregullt i tyre për vitin nuk mund të vlerësohej për këtë raport.

<sup>66</sup> As explained in sub-section 3.3 the Task Forces are not assessed in 2018 as new legally binding mechanisms are formally in place. With the adoption of the new Regulation in January 2018, new local level mechanisms (Municipal Commissions on Return) were established while the old policy framework mechanisms (MWGR and Task Forces) were abolished. In 2018, Municipal Commissions on Returns were being established so their regular functioning for the year could not be assessed for the present report.

## **Strategjitë komunale për kthimin**

Sipas Doracakut, komunat kërkohen që ta miratojnë dhe zbatojnë strategji komunale për kthim ashtu që të kenë synime dhe aktivitete të qarta në mbështetje të kthimit dhe riintegrimin të personave të zhvendosur në komunë.<sup>67</sup> ZKKK-të bashkërendojnë procesin e hartimit të strategjive, duke i angazhuar drejtoritë komunale përkatëse dhe anëtarët e GPKK-së. Strategjitë më pas miratohen nga ana e GPKK-së. Është shënuar përparim me numrin e komunave që kanë miratuar strategji komunale dhe/ose plane veprimi për aktivitetet e kthimit, me rritje nga pesë sa kanë qenë në vitin 2014 në 17 sosh në vitin 2018<sup>68</sup>. Sipas instrumentit për monitorim të Misionit të OSBE-së në Kosovë, vetëm tri komuna kanë ndarë buxhet në përkrahje të zbatimit të strategjive/planeve të veprimit.<sup>69</sup> Në kuadër të raportimit të tyre të rregullt, ZKKK i raportojnë kuvendit komunal, kryetarit të komunës dhe institucioneve qendrore në lidhje me aktivitetet e strategjisë. Në përgjithësi, zbatimi i strategjive zakonisht është i kufizuar në bashkëpunimin me projekte për kthim që financohen nga donatorët dhe në pjesëmarrjen e komunave në aktivitete që kanë të bëjnë me kthimin e që organizohen nga aktorë të jashtëm.

<sup>67</sup> Faqe 20, Doracaku, shënimi 32 *më sipër*.

<sup>68</sup> Prishtinë dhe Ferizaj (Strategjia 2014–2017 dhe Plani i Veprimit 2018), Gjilan, Mitrovicë, Gjakovë, Istog, Lipjan, Obiliq dhe Shtërpçë (Plani i Veprimit 2017 dhe Plani i Veprimit 2018–2020), Novobërdë (Plani i Veprimit 2017 dhe Plani i Veprimit 2018–2020), Kamenicë/Kamenica dhe Prizreni (Strategjia 2016–2018 dhe Plani i Veprimit 2018), Fushë Kosovë dhe Graçanicë (Strategjia 2017 dhe Plani i Veprimit 2017–2018), Lipjan (Plani i Veprimit 2017–2018), Shtime (Strategjia 2017 dhe Plani i Veprimit 2018), Rahovec (Strategjia 2017–2018 dhe Plani i Veprimit 2017–2018).

<sup>69</sup> Novobërdë ka ndarë 3,500 Euro në vitin 2016 dhe 17,800 Euro në vitin 2017, por ky buxhet nuk është shpenzuar. Fushë Kosova ka ndarë 309,000 Euro në vitin 2016, dhe Obiliq ka ndarë 5,000 Euro në vitin 2016.

## 4. ÇËSHJET PRONËSORE<sup>70</sup>

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, personat e zhvendosur kanë vazhduar të përballen me sfida në kuptim të gëzimit të të drejtave të tyre pronësore dhe banesore. Problemet kryesore që janë identifikuar përfshijnë (ri)uzurpimin e kundërligjshëm të pronës, moszbatimin e urdhrave për shembje dhe të skemës së kompensimit nga ana e Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP), qasjen e kufizuar në mundësi të qëndrueshme të banimit social dhe ndarje të tokës për projekte të kthimit.

Është vërejtur progres me adresimin e të drejtave pronësore të komuniteteve joshumicë dhe personave të zhvendosur me miratimin e Strategjisë së Kosovës për të Drejtat Pronësore në vitin 2016.<sup>71</sup> Strategjia përmban një kapitull të veçantë për të drejtat pronësore të personave të zhvendosur dhe kërkon nga institucionet që t'i përmbahen dhe t'i respektojë konventat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe protokollat e tyre, e në veçanti "Parimet e Pinheiros."<sup>72</sup> Në mënyrë specifike, Strategjia identifikon çështje që lidhen me gëzimin e të drejtës pronësore nga anëtarët e komuniteteve dhe personat e zhvendosur dhe ofron politika udhëzuese për adresimin e tyre. Në mesin e çështjeve përfshihen zbatimi i vendimeve për dëbimin e uzurpuesve të paligjshëm, komunikimi më i mirë dhe njoftimi i personave të zhvendosur, ofrimi i ndihmës juridike pa pagesë për personat e zhvendosur, lirimi nga pagesa e tarifave gjyqësore, respektim i plotë i Ligjit për përdorimin e gjuhëve për t'ua mundësuar personave të zhvendosur që të kërkojnë dhe pranojnë dokumente në gjuhën e tyre amtare<sup>73</sup>, gjykimi i rasteve të transaksioneve pronësore mashtruese dhe për raste të tatimit të grumbulluar pronësor, ndarja e tokës për projekte të lidhura me kthim, si dhe harmonizimi i Strategjisë për Vendbanimet Joformale me dispozitat e Ligjit për Planifikim Hapësinor. Strategjia është dokument i politikave kyçe të qeverisë për të drejtat pronësore, prandaj në të ardhmen pritet qasje më e strukturuar ndaj zgjidhjes së të drejtave pronësore të personave të zhvendosur dhe komuniteteve më të cenueshme.<sup>74</sup>

Sa i përket zbatimit të tij, është vërejtur progres në adresimin e çështjes së tatimit në pronën e paluajtshme në pronësi të personave të zhvendosur. Në janar 2018, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për tatimin në pronë të paluajtshme,<sup>75</sup> me të cilin sigurohet lirimi i personave të zhvendosur nga pagesa e tatimit të grumbulluar në pronë gjatë kohës sa kanë qenë të zhvendosur. Ligji hyri në fuqi më 1 tetor 2018, dhe komunat do të obligohen që të shlyejnë të gjitha detyrimet pronësoro-tatimore të personave të zhvendosur me të drejta pronësore për

<sup>70</sup> The detailed description regarding the state of conflict-related property cases in Kosovo will be included in a public report planned to be published by the OSCE Mission in Kosovo in 2019.

<sup>71</sup> Strategjia e Kosovës për të Drejtat Pronësore, tetor 2016: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/SKDP\\_17\\_10\\_2016\\_ENG.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/SKDP_17_10_2016_ENG.pdf).

<sup>72</sup> Parimet për rikthimin e banimit dhe pronës për refugjatët dhe personat e zhvendosur (E/CN.4/Sub.2/2005/17), 11 gusht 2005 ("Parimet Pinheiro").

<sup>73</sup> Ligji nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, 27 korrik 2006.

<sup>74</sup> Shumë pjesë të Strategjisë ende duhet të përkthehen në ligje të reja, apo ndryshim të atyre ekzistues. Megjithatë, Ligji i ri për tatimin në pronën e paluajtshme që i liron personat e zhvendosur nga pagesa e faturave dhe borxhit të akumuluar është një nga shembujt e mirë që burojnë direkt nga Strategjia.

<sup>75</sup> Ligji nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme. Ligji u publikua në Gazetën Zyrtare më 14 shkurt 2018, dhe hyn në fuqi më 1 tetor 2018.

periudhën gjatë së cilës prona e tyre ka qenë e uzurpuar, bazuar në vendimin përfundimtar të lëshuar nga një institucion publik në Kosovë i autorizuar për të shqyrtuar raste të uzurpimit.<sup>76</sup>

Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) me mandat për të pranuar, regjistruar dhe zgjidhur kërkesat pronësore, përfundoi mandatin e saj në nëntor 2016, pasi që kishte vendosur për të gjitha kërkesat e pranuar.<sup>77</sup> Pasardhëse e AKP-së ishte AKKVP,<sup>78</sup> e cila e trashëgoi një pjesë të mandatit të AKP-së që lidhet me zbatimin e vendimeve dhe të skemës së qiradhënies për pronat nën administrim.<sup>79</sup>

Përkundër përparimeve të vërejtura në zgjidhjen e kërkesave pronësore, çështja e ri-uzurpimit të pronave pas dëbimit të uzurpuesve vazhdoi të ndikonte negativisht në gëzimin paqësor të drejtave pronësore nga pjesëtarët e komuniteteve duke përfshirë personat e zhvendosur.<sup>80</sup> Në raste të tilla, parashtruesit e ankesave duhej t'i nënshtroheshin procedurave të gjata gjyqësore për të liruar pronat e tyre nga uzurpuesit, pasi që AKKVP mund të realizonte ligjërisht vetëm dy dëbime për rast. Gjatë periudhës së raportimit, AKKVP ka ekzekutuar 2,929 dëbime fizike, duke i liruar pronat me përkrahjen e Policisë së Kosovës.<sup>81</sup> Procesi i dëbimit në komunat veriore rifilloi në mars të vitit 2014, dhe prej atëherë gjithsej 19 dëbime u kryen nga ana e AKKVP-së.<sup>82</sup> Përveç kësaj, 16 raste të ri-përfshirjes së paligjshme të pronave janë regjistruar pas zbatimit të dëbimeve bazuar në kërkesat e riposedimit, të cilat i janë drejtuar nga AKKVP në prokurori publike për procedime të mëtutjeshme.<sup>83</sup> Përveç kësaj, Ligji për AKKVP-në ka prezantuar një periudhë 18-mujore për ndërprerjen e administrimit të pronave, duke përfshirë administrimin e skemës së qiradhënies, pas miratimit të Ligjit për AKKVP. Revokimi i kompetencave të AKKVP-së për të administruar pronat dhe për të kryer dëbimet pas dy uzurpimeve është vlerësuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit si shkelje e mundshme e të drejtave pronësore.<sup>84</sup> Ndërprerja e administrimit nën mbikëqyrjen e AKKVP-së do të krijonte situatë ku këto prona nuk do të kishin asnjë mbrojtje, pasi asnjë institucion në Kosovë nuk mund ta merrte këtë përgjegjësi. Si pasojë, kjo do t'i ekspozonte pronat e personave të zhvendosur dhe numri i uzurpimeve do të rritej. Sa i përket zbatimit të vendimeve, kufiri i dy dëbimeve të uzurpuesve nuk do të sigurojë mbrojtje të mjaftueshme për palët e prekura, pasi disa prona të personave të zhvendosur janë riuzurpuar shumë herë.

Prandaj, më 19 tetor 2017, Institucioni i Avokatit të Popullit nxori raport mbi *revokimin e kompetencave të caktuara të Agjencisë Kosovare të Krahasimit dhe Verifikimit të Pronës, sipas Ligjit Nr. 05 / L-010 mbi Agjencinë Kosovare të Krahasimit dhe Verifikimit të Pronës*, duke rekomanduar që institucionet kompetente të ndryshojnë dhe të plotësojnë Ligjin për AKKVP-në me qëllim që të lejojë vazhdimin e administrimit të pronave dhe mundësinë për të zbatuar

<sup>76</sup> Gjykatat, Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës apo ndonjë institucion tjetër publik.

<sup>77</sup> Shih AKP/AKKVP Raporti Vjetor 2016.

<sup>78</sup> Ligji nr. 05/L-010 për Agjencinë e Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, 28 dhjetor 2016.

<sup>79</sup> Shënim: Ndonëse transferimi i kompetencave për zbatimin e vendimeve dhe administrimin e pronave, duke përfshirë këtu skemën e qiradhënies, është përgjegjësi të rëndësishme të AKKVP-së për mbrojtjen e të drejtave pronësore të personave të zhvendosur, përgjegjësi kryesore e AKKVP-së është krahasimi dhe verifikimi i regjistrave kadastral të cilat janë marrë nga autoritetet e Serbisë kur u larguan nga Kosova më 1999, dhe regjistrit të ri kadastral të krijuar në Kosovë.

<sup>80</sup> Shih gjithashtu raportin e OSBE-së "Shqyrtimi i rasteve të riuzurpimeve të paligjshme në Kosovë," janar 2015, në dispozicion në: <https://www.osce.org/kosovo/141131>.

<sup>81</sup> 945 në 2015, 1,125 në 2016, 899 në 2017 dhe 321 në 2018

<sup>82</sup> 10 dëbime janë kryer nga marsi 2014 deri në fund të 2015, tre në 2016, katër në 2017 dhe dy në 2018

<sup>83</sup> Shtate raste në 2015, pesë në 2016, dy në 2017 dhe dy në 2018.

<sup>84</sup> Shih Raportin e Avokatit të Popullit, gjendet në: [http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/ANG--17-10-2017\\_Raporti\\_per\\_AKKVP\(1\)-1\\_922339.pdf](http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/ANG--17-10-2017_Raporti_per_AKKVP(1)-1_922339.pdf).

dëbime shtesë pas çdo riuzurpimi të pronave.<sup>85</sup> Pas këtij raporti, Zyra e Kryeministrit i adresoi rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe dërgoi ndryshim-plotësimin në ligj për miratim në Kuvend të Kosovës, ku është në pritje për veprime të mëtutjeshme.

Për sa i përket mandatit të AKKVP-së për zbatimin e vendimeve të lëshuara nga Komisioni i mëparshëm për Kërkesa Pronësore dhe Banesore<sup>86</sup> që nga dhjetori i vitit 2016, AKKVP nuk ka qenë në gjendje të zbatojë skemën e kompensimit për të ashtuquajturat kërkesa<sup>87</sup> A dhe C, dhe të zbatojë kërkesat për rrënimin e objekteve të ndërtuara<sup>88</sup> në mënyrë të paligjshme, përkundër faktit që për këtë i janë ndarë AKKVP-së 30,000 Euro. Në të dy rastet, Gjykata Kushtetuese vendosi që AKKVP-ja është përgjegjëse për zbatimin e këtyre vendimeve, meqë ato kanë ndikim të ndjeshëm në të drejtat pronësore të personave të zhvendosur dhe urdhëroi AKKVP-në të ndërmarë masa për zbatimin e tyre.<sup>89</sup> Ndonëse paksa jashtë periudhës për të cilën raportohet, në janar 2019 AKKVP angazhoi një kompani private për të kryer prishjen e strukturave të paligjshme.

Për sa i përket çështjes së personave të zhvendosur pa pronë, ndarja e tokës në pronësi komunale për t'i adresuar nevojat banesore të personave të zhvendosur vazhdoi të jetë problematike për komunat. Gjatë periudhës raportuese, pesë komuna janë përgjigjur pozitivisht ndaj projekteve të lidhura me kthimin duke ndarë tokë në pronësi komunale në të mirë të familjeve të zhvendosura pa pronë<sup>90</sup>, ndërsa komuna e Ferizajt dhe e Gjilanit nuk ishin në gjendje të përgjigjeshin ndaj kërkesave për ndarje të tokës për këtë qëllim. Ndërkohë, gjatë monitorimit të tij, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka gjetur se shumë komuna ende nuk kanë të dhëna të plota për tokën e tyre, ose në disa raste nuk kanë tokë në pronësi komunale<sup>91</sup>. Në rrethana të tilla, komunat kanë dy opsione alternative të parapara me ligj<sup>92</sup>. Ato mund ose të kërkojnë shkëmbimin e tokës nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ose nga qeveria, ose rivendosjen e pronësisë mbi tokën e ndërmarrjeve shoqërore. Si rezultat i monitorimit të Misionit të OSBE-së në Kosovë u zbulua se, në praktikë, zbatimi i këtyre opsioneve pengohet për shkak të paqartësive procedurale dhe vonësive në krijimin e një organi kompetent për të vendosur mbi kërkesat e komunës. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal shpesh përgjigjet me vonësë në kërkesat e komunave për ndarjen e tokës. Për më tepër, institucionet e Kosovës nuk ia kanë caktuar përgjegjësinë një organi të vetëm që do të merrej me të gjitha nivelet e koordinimit, për të siguruar disponueshmëri të tokës për komunat, për projektet e lidhura me kthimin. Sidoqoftë, në korrik 2018, Qeveria aprovoi 23 kërkesa të komunave (të

<sup>85</sup> Po aty.

<sup>86</sup> Në lëndët e pazgjdhura të ish-Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore/ Komisionit për Kërkesa Pronësore-Banesore (DÇPB/KKPB) ekzistojnë 143 vendime të KKPB-së ku janë dy paraqitës të suksesshëm të kërkesës për të njëjtën pronë. Në këto raste, kompensimi monetar për humbjen e të drejtave të tyre banesore iu dha një paraqitësi të kërkesës, ndërsa kërkesit tjetër iu dha posedimi i pronës. Shih nenin 4, Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/60 mbi Kërkesat Pronësore-Banesore dhe Rregulloren e Punës dhe Provave të Drejtorisë për Çështje Pronësore Banesore dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore - Banesore. Vlen të theksohet që qeveria ka ndarë 600,000 euro për kompensimin e kërkesave të kategorisë A dhe C për vitin buxhetor 2017/2018 dhe janë zotuar edhe 600,000 për vitin 2019.

<sup>87</sup> Kategorija A: kërkesat e personave fizikë, pronësia, posedimi ose shfrytëzimi i të drejtave pronësore i të cilëve ndaj një prone banesore ishte revokuar pas datës 23 mars 1989 në bazë të legjisllacionit diskriminues; Kategorija C: kërkesat e personave fizikë që ishin pronarë, posedues ose bartës të së drejtës banesore të pronës së patundshme banesore para 24 marsit 1999, të cilët nuk gëzojnë posedimin e pronës dhe kur pasuria nuk është transferuar vullnetarisht.

<sup>88</sup> Në 2017 qeveria ka ndarë gjithsej 30,000 euro për prishjen e objekteve ilegale.

<sup>89</sup> Aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese Nr. K187/13, e datës 16 prill 2015; dhe K1144/14 dhe K1156/14 të datës 4 gusht 2015.

<sup>90</sup> Në 2015, Gjakova ndau 22 parcela dhe Graçanica tetë parcela; në 2016, Klina ndau pesë parcela, Peja 13 parcela dhe tre të tjera shtesë në 2017; dhe Istogu ndau tre parcela në 2015 dhe shtatë të tjera shtesë në 2016.

<sup>91</sup> Pejë, Klinë, Istog, Gjakovë, Prishtinë, Graçanicë, Shtime, Obiliq, Lipjan, Partesh, Shtërpcë, Gjilan, Ferizaj dhe Kamenicë.

<sup>92</sup> Neni 12 dhe 13, Ligji nr. 04 / L-144 për dhënie në shfrytëzim dhe shkëmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, 22 nëntor 2012.



përcjella përmes MAPL) për tërheqje nga procesi i privatizimit të parcelave të kërkuara të tokës dhe transferim të pronësisë së tyre te komuna. Tërheqja e parcelave nga menaxhimi i AKP-së dhe procesi i privatizimit ishte i justifikuar me nevojat e komunave për të mbështetur interesin publik. Pas këtyre vendimeve, MAPL dhe AKP ishin të detyruara të zhvillonin procedura për transferimin e pronës (pronësisë) nga AKP-ja te komuna. Në anën tjetër, këto vendime të Qeverisë shkaktuan reagim të Presidentit i cili kundërshtoi vendimet në Gjykatën Kushtetuese më 16 nëntor 2018 duke parashtruar kërkesë për vlerësimin e konfliktit të pretenduar midis kompetencave kushtetuese të Presidentit dhe Qeverisë, siç përcaktohet me nenin 113.3 (1) i Kushtetutës, në lidhje me vendimin e Qeverisë për transferimin e disa pronave në pronësi publike dhe shoqërore në përdorim ose pronësi të komunave. Më 1 korrik 2019, Gjykata Kushtetuese deklaroi se kërkesa e Presidentit është e papranueshme.<sup>93</sup> Prandaj, vendimet e cekura të Qeverisë kanë efekt juridik, në pritje të zhvillimit të procedurave për transferimin e pronave nga AKP te komunat. Përfundimisht, disa komuna shënuan progres në miratimin e programeve trevjeçare komunale për banim.<sup>94</sup> Megjithatë, ato nuk e financuan në mënyrë adekuate zbatimin e tyre.<sup>95</sup> Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) si ministri përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe mbështetjen e komunave për banim social ndau 100,000 euro linje buxhetore nga Ministria e Financave për të përkrahur procesin<sup>96</sup>. Prandaj, përkundër përmirësimeve në legjislacion dhe politika, rezultatet konkrete janë të pakta dhe kryesisht të mbështetura nga donatorët.<sup>97</sup> Komunat kanë burime të kufizuara dhe ndërhyrjet e tyre kryesisht janë të orientuara drejt subvencionimit të një pjese të qirasë për ata që kanë nevojë për banim social, në vend që të sigurojnë banim të qëndrueshëm.

Progres është vërejtur edhe në procesin e shpronësimit, ku komunat kanë përmirësuar procedurat lidhur me njoftimin e personave të zhvendosur dhe përputhshmërinë me kërkesat gjuhësore sipas kornizës ligjore.<sup>98</sup> Për më tepër, institucionet kanë përmirësuar shtrirjen e tyre dhe informojnë rregullisht banorët e prekur për efektet e shpronësimit në komunat e tyre. Për shembull, MMPH organizoi dëgjime publike me pronarët e prekur me ndërtimin e rrugëve në komunat e Gjilanit, Parteshit, Klllokotit, Vitisë dhe Novobërdës. Takimet u organizuan në bashkëpunim të ngushtë me komunat përkatëse dhe vendimet për shpronësim u dorëzuan në të dy gjuhët zyrtare. Megjithatë, kërkohet monitorim i mëtejshëm ashtu që të sigurohet se institucionet komunale respektojnë plotësisht të drejtat pronësore. Fokus i veçantë duhet t'i kushtohet kontaktimit të personave të zhvendosur, kur pronat e tyre preken.

<sup>93</sup> Gjykata Kushtetuese, vendimi për papranueshmërinë në rastin nr. K0181/18. I qasshëm në: <http://gjk-ks.org/en/decision/kerkese-per-vleresimin-e-konfliktit-te-pretenduar-te-kompetencave-kushtetuese-ne-mes-te-presidentit-te-republikes-se-kosoves-dhe-qeverise-se-republikes-se-kosoves-sic-percaktohet-me-nenin-113-3-1-t/>.

<sup>94</sup> Ligji Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, 25 shkurt 2010

<sup>95</sup> Komunat që hartuan dhe/ose miratuan plane trevjeçare për banim social gjatë periudhës raportuese janë: Prishtina, Gjilani, Ranillugu, Fushë Kosova, Peja dhe Deçani.

<sup>96</sup> Interviste me znj. Merita Dalipi, zyrtare e lartë për banim social, MMPH, 6 mars 2019.

<sup>97</sup> OJQ vendore Advancing Together ka përkrahur MMPH-në me asistim në hartimin e programeve trevjeçare të banimit social në shtatë komuna dhe krijimin e databazës për përfituesit nga banimi social, bazuar në Projektin e financuar nga BE. Shih: <http://www.developingtogether.org/?page=2,64>

<sup>98</sup> Ligji Nr. 03 / L-205 për Shpronësimin e pronës së paluajtshme, 10 dhjetor 2010, dhe Ligji Nr. 02 / L-37 për përdorimin e gjuhëve, 27 korrik 2006.

## 5. ÇËSHTJET E SIGURISË

### 5.1 Siguria e të kthyerve dhe në vendet e kthimit

Misioni i OSBE-së në Kosovë monitoron dhe regjistron<sup>99</sup> incidentet që ndikojnë në sigurinë e komuniteteve në Kosovë. Në periudhën midis janarit 2015 dhe dhjetorit 2018, Misioni ka regjistruar 1,518 incidente të sigurisë të cilat potencialisht kanë ndikuar në perceptimet e sigurisë së komuniteteve në pakicë numerike në nivelin komunal. Nga këto incidente, 346 raste (rreth 25 për qind e numrit të përgjithshëm të incidenteve) kanë ndikuar në vendet e kthimit dhe kryesisht tek të kthyerit serbë.<sup>100</sup> Në përgjithësi, incidentet që prekin vendet e kthimit kanë tendencë të shënohen më shpesh në vendet ku regjistrohet një përqindje më e madhe e kthimeve, siç janë komuna e Pejës, Istogut dhe Klinës. Në krahasim me raportin e vitit 2014, kjo periudhë raportuese ka regjistruar të njëjtën natyrë të incidenteve të sigurisë që ndikojnë tek të kthyerit dhe në vendet e kthimit. Monitorimi i Misionit të OSBE-së në Kosovë regjistroi si llojin më të shpeshtë të incidentit vjedhjen me thyerje ashtu dhe vjedhjen që ka për cak shtëpitë e pabanuara të serbëve të Kosovës. Ndonëse vjedhjet e tilla mund të kenë motiv thjesht ekonomik, lajmet rreth tyre priren të përhapen përmes mediave dhe sipas monitorimit të Misionit të OSBE-së në Kosovë, incidentet e tilla në shumë raste dekurajojnë kthimin e të kthyerve potencialë, veçanërisht kur kryesit e krimit mbeten të pafidentifikuar. Ndonëse PK kishte iniciuar hetimet e këtyre incidenteve, prokurorët shpeshherë nuk janë në gjendje t'i procedojnë këto raste për shkak të mungesës së informatave në lidhje me identitetin e të dyshuarve për këto vepra.

Incidentet gjithashtu përfshijnë vjedhje të përsëritura të vogla dhe dëmtim të pronës në zonat e banuara vazhdimisht nga të kthyerit.<sup>101</sup> Prerja e paligjshme e pyjeve në pronësi private në vendet e kthimit është regjistruar kryesisht në komunën e Pejës dhe të Istogut.<sup>102</sup> Për shembull, një i kthyer i moshuar u sulmua fizikisht në Osojan në tetor 2016 duke e mbrojtur pyllin e tij nga prerja e paligjshme e druve. Kishat dhe objektet e trashëgimisë fetare, duke përfshirë

---

<sup>99</sup> Monitorimi i OSBE-së regjistron incidente të cilat konsiderohen se mund të ndikojnë në komunitetet që janë pakicë numerike në nivel komunal, duke përfshirë komunitetin shqiptar të Kosovës në komunat me shumicë serbe të Kosovës. Informacioni mblidhet nga burime të ndryshme, siç janë intervistat e stafit të OSBE me anëtarët e komunitetit dhe zyrtarët komunalë, raportet nga organizatat e tjera ndërkombëtare, raportet e Policisë së Kosovës dhe raportet e medias.

<sup>100</sup> Dëmtim i dyerve dhe dritareve, vjedhje e pajisjeve shtëpiake dhe mobileve, si dhe artikujve ushqimor raportohen shpesh. Në disa raste, janë regjistruar shkatërrimi i bunarëve, gardheve të oborrit dhe objekteve të tjera në afërsi të shtëpive. Incidente të tilla kanë ndodhur kryesisht në Klinë, Pejë dhe Istog.

<sup>101</sup> Për shembull, një grua e moshuar serbe e Kosovës, e kthyer në Pjeterq i Poshtëm në komunën e Klinës ka qenë objekt i vjedhjeve gjashtë herë gjatë periudhës për cilën raportohet. Në këto incidente, asaj iu vodhën 26 pula, ndërsa gjatë një sulmi u plagos lehtë teksa përpiqej të mbronte pronën e saj.

<sup>102</sup> Raportet zakonisht përfshijnë zonat rreth fshatrave Lëvoshë në Pejë dhe Tuqep, Kosh, Osojan në komunën e Istogut dhe Brestovik në komunën e Pejës.

varrezat në vendet e kthimit, ishin prekur gjithashtu gjatë periudhës raportuese<sup>103</sup>, e edhe vizitat e pelegrinëve në vendet fetare ortodokse kanë qenë objekt i incidenteve të sigurisë.<sup>104</sup>

Përveç kësaj, kanë qenë pesë incidente me armë zjarri,<sup>105</sup> përfshirë dy raste ku mjete shpërthyes janë hedhur në drejtim të një shtëpie të sapo-rindërtuar.<sup>106</sup> Tre incidente të zjarrvënies përfshinë djegien e dy shtëpive të pabanuara të të kthyerve, në Kllokot në dhjetor 2016, dhe në Sigë në Pejë në nëntor 2016 dhe në Bellopojë, komunë të Pejës në tetor 2018.

## 5.2 Reagimet e institucioneve të Kosovës ndaj incidenteve të sigurisë

Në shumicën e rasteve, të kthyerit kanë raportuar incidente në vendet e kthimit dhe incidente që prekin vendet fetare në PK. Megjithatë, herë pas here, anëtarët e komunitetit deklarojnë se ndihen të dekurajuar për t'i raportuar incidentet meqë rastet e mëparshme kanë treguar se është vështirë që autorët të identifikohen.<sup>107</sup> Sipas monitorimit të Misionit të OSBE në Kosovë, kjo ndikon drejtpërdrejt në perceptimin e sigurisë të të kthyerve dhe ndikon në procesin e kthimit. Kryetarët e komunave dhe zyrtarët tjerë të lartë komunalë zakonisht dënojnë incidentet e rënda, si zjarrvëniet, vrasjet ose sulmet.<sup>108</sup> Ministri për Komunitete dhe Kthim rregullisht publikon dënime të menjëhershme publike të incidenteve të tilla dhe në disa raste realizon vizita. Disa incidente të sigurisë që prekin komunitetet janë dënuar edhe nga

<sup>103</sup> Në vitin 2015, 2016, 2017 dhe 2018 grafitë kundër serbëve u shkruan katër herë në muret e Kishës Ortodokse Serbe (KOS) manastiri i Virgjëreshës së Shenjtë në Gjakovë. Grafitet ishin shkruar edhe në muret e oborrit të KOS të Shpalljes së Virgjëreshës së Shenjtë në Lipjan, KOS të Shën Pjetrit në fshatin Brod në komunën e Shtërpçës, në muret e varrezave ortodokse serbe në Prizren dhe KOS Shën Nikolla në Prishtinë. Kishte pesë vjedhje në manastirin e Gorioçit në komunën e Istogut dhe tre në manastirin Shën Kozma dhe Damjan në Zoqishtë në komunën e Rahovecit gjatë periudhës raportuese. Janë raportuar tri raste të hedhjes së gurëve nga famullitë në Vushtrri, Rahovec dhe KOS të Shën Pjetrit dhe Palit në Talinoc në komunën e Ferizajt. Për dëmtim të gurëve të varreve është raportuar në Videjë dhe Deiq në komunën e Klinës dhe në Brestovik në komunën e Pejës.

<sup>104</sup> Më 28 gusht 2015, një mjet shpërthyes u gjet në vendin e manastirit ortodoks serb të shkatërruar të Trinisë së Shenjtë e në fshatin Mushtisht, Suharekë dhe rreth 500 shqiptarë të Kosovës bllokuan rrugën kur pelegrinët serbë të Kosovës (duke përfshirë edhe të kthyerit potencialë) u përpoqën të vizitoni manastirin e shkatërruar, një vend ky që ka përjetuar incidente të sigurisë edhe në të kaluarën. Më 21 gusht të vitit 2016, në këtë fshat u vendos një tabelë ku shkruhej "Kjo është ajo që serbët vendas të Mushtishtit lanë pas vetës kur u larguan", të shkruar në gjuhën shqipe dhe angleze, duke shfaqur fotografi të mizorive dhe shkatërrimeve nga lufta; ndërsa më 28 gusht 2016, rreth 500 shqiptarë të Kosovës bllokuan rrugën duke i parandaluar pelegrinët që të afrohen në këtë vend. Më 28 gusht 2017, një serb i Kosovës, potencialisht i kthyer, anëtar i grupit punues për kthimin në Mushtisht u arrestua pas vizitës së pelegrinëve, bazuar në akuzat e pretenduara për krime lufte. Ai kaloi pesë muaj në burg, pas së cilës kohë ai u lirua dhe u shfaqësua nga të gjitha akuzat. Më 5 janar 2018, një grup i personave të zhvendosur serbë të Kosovës, me prejardhje nga Gjakova dhe aktualisht me banim jashtë Kosovës, anuluan vizitën e tyre për Krishtlindjet ortodokse në Gjakovë të planifikuar për 6 janar, për shkak të shqetësimeve të sigurisë dhe kërcënimeve të pohuara që u publikuan në mediat sociale. Më 28 maj 2018 në Potërq të Ultës, Klinë, një grup i përbërë prej 50-60 shqiptarëve të Kosovës u mblodhën në gërmadhat e kishës ortodokse serbe të shkatërruar të "Trinisë së Shenjtë", në mënyrë që të protestonin dhe të parandalonin përkujtimin nga pelegrinët serbë. Më 28 gusht 2018, një grup banorësh shqiptarë u mblodh afër Manastirit Ortodoks Serb në qytetin e Gjakovës për të protestuar kundër vizitës së paralajmëruar të pelegrinëve dhe personave të zhvendosur. Më 21 tetor 2018, dy autobusë me targa regjistrimi të Beogradit që bartnin pelegrinë, duke përfshirë edhe persona të zhvendosur serbë të Kosovës, u qëlluan me gurë në rrugën e tyre për gërmadhat e kishës ortodokse serbe Bogorodica Hvostanska në Studenicë, Komuna e Istogut.

<sup>105</sup> Në Serbobran të Istogut në dhjetor 2015, Berkovë të Klinës në janar 2016, Rudicë të Klinës në prill 2016, Biqë të Klinës në nëntor 2017, dhe në Zallç në Istog në gusht 2018, kryerësit qëlluan në drejtim të pronave të të kthyerve, por nuk është raportuar për të lënduar.

<sup>106</sup> Dragolec, komuna e Istogut, iu vu zjarri materialit ndërtimor në prill 2017 dhe një mjet shpërthyes u hodh në maj 2017, një ditë pasi një i kthyer serb i Kosovës pranoi çelësat e shtëpisë. Në vitin 2018, pati gjashtë incidente në të cilat u ndezën duaj kashte dhe pyje në fshatrat e të kthyerve në komunat e Istogut dhe Klinës. Në tetor 2018, një mjet shpërthyes u gjet pranë qendrës së të rinjve në Osojan në komunën e Istogut. Gjithashtu, në tetor 2018, në po atë muaj, u dogj një shtëpi që i përkiste një familjeje të të kthyerve serbë të Kosovës në fshatin Bellopojë, komuna e Pejës, si rezultat i zjarrvënies

<sup>107</sup> Shih Raportin e OSBE-se (2014), f. 17, *shënim 1* më sipër.

<sup>108</sup> Gjithsej 25 dënime më 2015, 23 më 2016, 21 më 2017 dhe 18 në 2018.

Presidenti i Kosovës, Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe Kryeministri.<sup>109</sup> Megjithatë, monitorimi i Misionit të OSBE-së në Kosovë tregon se jo të gjitha dënimet arrijnë tek komunitetet e prekura ose popullsia shumicë në atë zonë. Deklaratat e dënimit zakonisht publikohen në faqet e internetit të komunës ose tabelat e informacionit, dhe jo në mediat lokale (transmetuese). Në përgjithësi, dënimet e shpejta dhe vizitat në terren nga zyrtarët e lartë janë vendimtare në trajtimin e ndikimeve negative mbi perceptimet e sigurisë së të kthyerve të shkaktuara nga incidentet e sigurisë.

Një zhvillim pozitiv ka qenë krijimi i Grupit Punues Ndërmator të Kthimit i udhëhequr nga MKK, më 25 maj 2015, për të zgjidhur çështjet e lidhura me kthimin e shqiptarëve të zhvendosur në lagjen Kroi i Vitakut në Mitrovicën e Veriut. Grupi përbëhet nga Ministri për Komunitete dhe Kthim, Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, kryetarët e Mitrovicës së Veriut dhe Mitrovicës Jugore, dy përfaqësues të të kthyerve shqiptarë dhe banorë serbë të Kroit të Vitakut si dhe përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare.<sup>110</sup> Megjithatë, gjatë periudhës së raportimit Grupi Punues u takua vetëm një herë.

Hap tjetër përpara në vitin 2017 ishte zhvillimi i Udhëzimeve për reagimet e mekanizmave të nivelit lokal ndaj incidenteve që prekin komunitetet, nga nëngrupi punues i zbatimit të Procesit të Shkupit për siguri, dialog dhe riintegrim (shih Pjesën 7). Udhëzuesit paraqesin hapat që duhet ndjekur institucionet komunale, kryesisht kryetarët e komunave, këshillat komunale për siguri në bashkësi (KKSB) dhe ZKKK-të, me qëllim që të sigurojnë qasje efektive dhe të vazhdueshme në çështjet e sigurisë që kanë të bëjnë me komunitetet, përfshirë edhe të kthyerit. Udhëzuesi për reagimet e mekanizmave të nivelit lokal në incidentet që prekin komunitetet është hartuar nga MKK, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, me mbështetje të Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe UNHCR, dhe është shpërndarë tek ZKKK dhe kryetarët e komunave më 18 janar 2018. Pas miratimit të Udhëzimeve, Misioni i OSBE-së në Kosovë organizoi një seri trajnimesh në mbarë Kosovën për të prezantuar dokumentin dhe për të rritur kapacitetet e mekanizmave të nivelit lokal për të adresuar incidentet që prekin anëtarët e komuniteteve dhe, në veçanti, të kthyerit.

---

<sup>109</sup> Presidenti dënoi një incident që përfshin dëmtimin e pronave të një serbi të Kosovës në Dragolec / komuna e Istogut, në prill 2017, ndërsa edhe Presidenti edhe Kryeministri dënuan gjuajtjen e dy autobusëve që transportonin pelegrinë, përfshirë këtu edhe personat e zhvendosur serbë të Kosovës, në Studenicë, Komuna e Istogut në Tetor 2018 (shiko shënimin lartë **Error! Bookmark not defined.**).

<sup>110</sup> Shih Buletinin vjetor të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, janar-dhjetor 2015, në dispozicion në [http://mzp-rks.org/bilten/bilten\\_en.pdf](http://mzp-rks.org/bilten/bilten_en.pdf).

## 6. KOMUNITETI PRITËS DHE PROCESI I KTHIMIT

Raporti i OSBE-së për kthimet vullnetare i vitit 2014 theksoi se tensionet ndëretnike kanë çuar në stagnim të procesit të kthimit në disa fusha dhe konkludoi se është dashur përpjekje më e madhe nga të gjithë aktorët relevantë, për t'i trajtuar këto çështje dhe për të rigjallëruar mbështetjen e zbehur politike në procesin e kthimit. Këto konkluzë të shënuara në raportin e vitit 2014 janë ende të vlefshme.<sup>111</sup>

### 6.1 Pozicioni i komunitetit pritës

Gjendja në lokacionet sfiduese të kthimit e identifikuar në raportin e OSBE-së në vitin 2012<sup>112</sup> dhe 2014<sup>113</sup> nuk ka ndryshuar ndjeshëm meqë nuk ka pasur ndonjë kthim të organizuar në lokacionet e identifikuara që nga publikimi i këtyre raporteve. Incidentet më të rënda të identifikuara në këtë periudhë të raportimit përfshinin një sulm verbal ndaj tetë personave të zhvendosur të moshuar në dhjetor të vitit 2016, gjatë një vizite shko dhe shih në Deçan, që kërkoi evakuimin e personave të zhvendosur nga PK-ja.<sup>114</sup> Në korrik të vitit 2016, një i kthyer i moshuar serb në Deçan u sulmua fizikisht nga një shqiptar në floktari.<sup>115</sup> Në disa prej vendeve sfiduese të kthimit, komunitetet pritëse e kushtëzojnë procesin e kthimit me zgjidhjen e krimeve të luftës dhe personave të zhdukur. Komunitetet pritëse besojnë se të kthyerit kanë informacion që mund të çojë në identifikimin e autorëve dhe vendndodhjen e familjarëve të tyre të zhdukur.

Incidente tjera përfshinin protestat kundër kthimeve ose kundër vizitave të pelegrinëve. Për shembull, rreth 300 shqiptarë protestuan në fshatin Lubozhdë, komuna e Istogut, kundër kthimit të 13 të kthyerve serbë, kryefamiljarë, të cilët u kthyen në mënyrë spontane në fshat.<sup>116</sup> Gjithashtu ka pasur protesta dhe peticione nga banorët shqiptarë kundër vizitave të

<sup>111</sup> Përkritazi me këtë kapitull, raporti i OSBE-së i vitit 2014 konkludon se "incidentet e sigurisë vazhdojnë të prekin të kthyerit dhe vendet e kthimit dhe perceptimin e sigurisë së komuniteteve [...] dhe se kthimet gjithashtu janë prekur nga rezistenca e komuniteteve pritëse të cilët e kanë bllokuar kthimin potencial në disa lokacione në tërë Kosovën." Shih raportin e OSBE-së (2014), f. 22,, <https://www.osce.org/kosovo/129321?download=true>, shënimi sipër 2.

<sup>112</sup> Misioni i OSBE-së në Kosovë, Vlerësimi i Procesit të Kthimit Vullnetar në Kosovë, tetor 2012, në dispozicion në <https://www.osce.org/kosovo/96805?download=true>.

<sup>113</sup> Vendet e kthimit në vijim janë identifikuar si të vështirë: Kijevë dhe Mleqan (Komuna e Malishevës), Dvoran, Leshan, Mushtisht dhe Sopin (Suharekë), Komuna e Gjakovës, Drenovc, Dush, Shtupel (komuna e Klinës), Lubeniç (Pejë), Loqan (Deçan), Sillovi (komuna e Prishtinës). Neredime e Epërme, Talinoc i Muhaxherëve (komuna Ferizaj), Vërrnicë (komuna Vushtrri), Kroj i Vitakut (komuna Mitrovica e veriut), Runik, Kuçice (komuna Skenderaj), Korishë (komuna Prizren), Opterushë (komuna Rahovec), Muzhevinë (komuna Istog), Plemetinë (komuna Obiliq). Shih raportin e OSBE të 2014, shënimi 2 më sipër.

<sup>114</sup> Punonjësi i komunës akuzonte personat e zhvendosur për përfshirje në krime të luftës dhe kërcënonte kthimin e tyre nëse nuk zbulojnë vendndodhjen e personave të zhdukur shqiptarë.

<sup>115</sup> Kryerësi u akuzua për "shkelje të rendit dhe qetësisë publike", ndonëse viktima deklaroi në seancë gjyqësore se gjatë sulmit, kryerësi kishte përdorur deklaratë etnikisht nënçmuese ndaj tij dhe komunitetit serb të Kosovës.

<sup>116</sup> Protestuesit ishin veçanërisht të pakënaqur me kthimin e ish-komandantit të policisë serbe të Kosovës, të cilët pretendonin se kishte qenë i përfshirë në krime lufte gjatë konfliktit të vitit 1999 në Kosovë. Këshilltari i kryetarit të komunës së Istogut për çështjet e serbëve të Kosovës lëshoi një deklaratë duke thënë se të gjithë të kthyerit kanë kaluar kontrollet paraprake të kryera nga institucionet e Prishtinës dhe Beogradit dhe se ndaj asnjërit prej tyre nuk është ngritur padi dhe nuk janë në gjykim për krime të luftës.

planifikuara të pelegrinëve serbë në objektet fetare të KOS në Gjakovë.<sup>117</sup> Që nga incidenti i fundit në janar 2017, nuk ka pasur vizita të tjera të pelegrinëve në këtë komunë.<sup>118</sup>

Fshati Mushtist në komunën e Suharekës, si vend sfidues i kthimit, ka pasur një numër incidentesh, duke përfshirë protesta<sup>119</sup> dhe bllokadë rrugore nga rreth 500 shqiptarë për të parandaluar një vizitë pelegrinësh serbë në manastirin e shkatërruar, vendosjen e tabelave anti-serbe dhe arrestimin e një të kthyeri potencial serb të Kosovës bazuar në akuza për krime lufte, të cilat u hodhën poshtë më pas.<sup>120</sup> Pas incidenteve të 28 gushtit 2015, 2016 dhe 2017 në lidhje me shënimin e festës fetare "Ngritja në qiell e Zojës së Bekuar," më 2018, kjo festë u shënua nga pelegrinët serbë pa incidente apo kundërshtim të manifestuar për kthimin.

Pretendimet për krime të luftës kanë ndodhur në disa raste; në Uçë në komunën e Istogut, një person i zhvendosur ishte ngacmuar verbalisht nga një banor shqiptar i cili e akuzoi atë për krime të luftës gjatë konfliktit të vitit 1999. Ngjashëm, në Raçak të komunës së Shtimes, këshilli i fshatit ka dërguar letër proteste me akuza për krime lufte në ZKKK,<sup>121</sup> kundër kthimit të familjes së vetme serbe që kishte aplikuar për kthim. Në shkurt të vitit 2016, Gjykata Themelore në Pejë ngriti aktakuzë për krime lufte kundër 14 serbëve nga Klina, disa prej të cilëve ishin të kthyer potencialë në fshatrat e komunës.<sup>122</sup> Ishin edhe dy raste të arrestimit të të kthyerve potencialë nga Prizreni dhe dy nga Klina, duke përfshirë një grua, të gjitha të bazuara në akuza për krime lufte.<sup>123</sup>

## **6.2 Reagimet komunale ndaj kundërshtimit të kthimit**

Gjersa komunave u kërkohet të sigurojnë kushte për kthim të qëndrueshëm dhe stabilizim të komuniteteve, reagimet e tyre ndaj kundërshtimit të komunitetit pritës ndryshojnë shumë nga rasti në rast. Në pjesën më të madhe të lokacioneve sfiduese të kthimit, komunat nuk morën masa për të ndërmjetësuar me komunitetet pritëse në mbështetje të procesit të kthimit, përveç rastit të fshatit Lubozhdë në komunën e Istogut. Duke e pasur parasysh tendencën në rënie të kthimeve në vitet e fundit, ky kthim spontan i një grupi prej 13 individësh ishte, si i tillë, i pazakontë dhe kërkoi përpjekje më të bashkërenduara nga institucionet për të ofruar ndihmën e nevojshme.

Meqë këta të kthyer u kthyen në mënyrë spontane dhe si grup, kërkohet adresimi i nevojave të tyre më urgjente. Ministri për Komunitete dhe Kthim i mirëpriti të kthyerit në arrijten e tyre

<sup>117</sup> Rreth 100 persona, aktivistë të "Vetëvendosjes" dhe banorë të rastësishëm, protestuan kundër vizitës së pelegrinëve serbë në Gjakovë. Rreth 30 shqiptarë të Kosovës u përpoqën të thyejnë kordonin e PK-së që siguronin vizitën e pelegrinëve serbë në kishën ortodokse lokale dhe hodhën ngjyrë dhe fishekzjarre ndaj PK-së. Një protestues u arrestua dhe dy policë u lënduan gjatë arrestimit. Turma e protestuesve u shpërnda pa ndërprerë pelegrinët.

<sup>118</sup> Një grup i banorëve shqiptarë filloi një peticion kundër vizitës së planifikuar të pelegrinëve serbë në manastirin e KOS në Gjakovë për të marrë pjesë në kremtimin e "Ditës së Shën Gjergjit", shih shënimin më 86 sipër.

<sup>119</sup> Fshati Mushtist në komunën e Suharekës është vend i kthimit i prekur nga incidente të rregullta të sigurisë dhe protesta; më 28 gusht 2015, 2016 dhe 2017; ndërsa çdo Krishtlindje, pelegrinët ishin parandaluar të vizitojnë manastirin ortodoks serb në Gjakovë si dhe gjatë vizitave të pelegrinëve të organizuara në ditën e të Gjithë Shpirtrave, shih shënimin 104 sipër.

<sup>120</sup> Shih shënimin 104 sipër

<sup>121</sup> Pretendime se një nga anëtarët e familjes serbe ishte përfshirë në një masakër në Raçak, Shtime më 1999.

<sup>122</sup> Kjo aktakuzë është ngritur nga Gjykata Themelore në bashkëpunim me Departamentin e Krimeve të Luftës të Prokurorisë Speciale të Kosovës. Urdhra për arrestime janë lëshuar ndaj të akuzuarit dhe janë shpërndarë tek të gjitha stacionet policore në Kosovë, në pikat e kalimit kufitar dhe në aeroport.

<sup>123</sup> Tre të kthyer, përfshirë gruan, janë liruar (njëri nga të cilët u lirua jashtë periudhës për të cilën raportohet, mars 2019) ndërsa njëri është ende në paraburgim.

në fshat, ndërsa ZKKK, Manastiri i Deçanit, UNHCR-ja dhe Kryqi i Kuq u dhanë atyre paketa emergjente ushqimore dhe jo-ushqimore. Në të njëjtën kohë, pas një avokimi të suksesshëm me institucionet përkatëse, Misioni i OSBE-së në Kosovë mbështeti të kthyerit në procesin e marrjes së dokumenteve personale që ishte parakusht për qasje në shërbime dhe aplikim për ndihmë.

Një proteste dhe një mbishkrim ofendues pasuan kthimin spontan të këtij grupi,<sup>124</sup> të cilat sollën intervenimin e PK-së dhe një kërkesë, përmes KKS-së së Komunës Istog, për patrullime më të shpeshta të PK-së në këtë zonë. Ndërkohë, Ministri për Komunitete dhe Kthim e ka dënuar incidentin e grafitëve,<sup>125</sup> ndërsa komuna nuk ka reaguar publikisht. PK jo vetëm që rriti shpeshtësinë e patrullimit në dy herë në ditë, por edhe instaloi një pikë statike kontrolli të përkohshëm në fshat. Pasi vlerësoi se situata në fshat ishte më e qetë, PK-ja hoqi pikën statike të kontrollit, pas tre muajsh, por vazhdoi me patrulla të rregullta ditore dhe të natës. Këto patrulla u shtrinë në fshatrat e tjerë të banuar nga komunitetet joshumicë për të mbuluar një zonë më të gjerë. Pas këtij reagimi gjithëpërfshirës, PK vazhdon të vlerësojë rregullisht situatën në fshat dhe vendos patrulla sipas nevojës së identifikuar ose pas thirrjeve të banorëve.

Përveç punës së KKS-së dhe PK-së, kontaktimi i rregullt i KKS-së nga Istogu për t'ju siguruar udhëzim të dhe asistencë të domosdoshme të kthyerve është dëshmuar të jetë vegël shumë e dobishme në zgjidhjen e statusit të tyre. Mekanizmat e tjerë komunalë kanë mundur të ofrojnë përkrahje më adekuate.

Megjithatë, disa komuna kanë ndërmarrë hapa pozitivë dhe kanë bërë përparim të ndjeshëm në trajtimin e kundërshtimit për kthimet. Në një rast, komuna organizoi ngjarje sportive në mënyrë që të dërgonte një mesazh për bashkëjetesën paqësore të komuniteteve. Më 12 mars 2016, u zhvillua një turne futbollit me moton "Ndërtojmë të ardhmen së bashku" me pjesëmarrjen e administratës komunale të Klinës, KFOR-it slloven, si dhe anëtarëve të komunitetit serb të komunës. Në raste të tjera, komunat kanë kompensuar viktimat e incidenteve të sigurisë. Për shembull, komuna e Klinës i ka paguar 300 Euro një personi të kthyer serb të Kosovës si kompensim për 1000 dengjeve të sanës, ndërsa komuna e Istogut kompensoi financiarisht një familje serbe të Kosovës nga fshati i të kthyerve Sinajë në vlerë prej 300 Euro, për dëmin që rezulton nga djegia e 1.000 dengjeve të sanës, që u dogjën nga një person i panjohur.

Me iniciativën e Misionit të OSBE-së, përfaqësuesit e komunave të Pejës, Klinës, Istogut, Deçanit, Gjakovës dhe Junikut nënshkruan një deklaratë ndër-komunale për bashkëpunim më 28 maj 2018. Deklarata përmban zotime për përkrahje të iniciativave të dialogut ndërmjet komuniteteve në mënyrë të koordinuar. Që nga nënshkrimi, komunat u përfshinë në një numër aktivitetesh që mblodhën njerëz nga komunitete të ndryshme në Kosovë.<sup>126</sup>

Në disa raste, ZKKK së bashku me lidhshimin komunal janë angazhuar në iniciativa për ndërtimin e besimit dhe ndërmjetësuan mes komuniteteve pritëse dhe të kthyerve (potencialë), si në komunën e Istogut dhe të Klinës. Në mes të vitit 2018, me iniciativë të

<sup>124</sup> Më 1 prill 2017, pati një protestë kundër kthimit të kriminelëve të pretenduar të luftës në afërsi të shtëpisë ku jetonin të kthyerit në fshatin Lubozhdë, ndërsa më 1 nëntor 2017 banorët e fshatit zbuluan disa mbishkrime fyese në muret në hyrje të fshatit, që shfaqnin fjalë poshtëruese ndaj të kthyerve serbë të Kosovës.

<sup>125</sup> RTK Live, <http://www.rtklive.com/rtk2/?id=2&r=14308>.

<sup>126</sup> Shih nën-pjesën 6.3 për më shumë detaje.

Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe UNHCR, të dy këto komuna shprehën gatishmërinë për të përkrahur një pilot aktivitet për lehtësimin e dialogut ndërmjet komunitetit kthyes dhe atij pritës.<sup>127</sup>

Përkundër shembujve të iniciativave pozitive, përpjekjet e institucioneve të Kosovës janë kryesisht ad-hok dhe jositematike. Për të trajtuar këtë çështje në mënyrë gjithëpërfshirëse, nevojitet një përpjekje e harmonizuar nga të gjithë aktorët relevantë.

### **6.3 Deklaratat ndërkomunale të lehtësuara nga OSBE**

Më 2013, Misioni i OSBE-së në Kosovë filloi promovimin e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve komunitare në katër komuna të rajonit të Gjilanit<sup>128</sup>, kur edhe u nënshkrua deklarata e parë ndër-komunale për promovimin e dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve nga zyrtarët përkatës komunalë. Kjo iniciativë ka vepruar si katalizator për rajone të tjera në Kosovë, me rajonin e Prishtinës<sup>129</sup>, Prizrenit<sup>130</sup>, Pejës<sup>131</sup>, dhe Mitrovicës<sup>132</sup> që përfundimisht ndoqën këtë model. Aktualisht, pas përpjekjeve të vazhdueshme të Misionit të OSBE-së në Kosovë, gjithsej 29 komuna të Kosovës<sup>133</sup> janë zotuar të promovojnë kolektivisht marrëdhënie të mira midis komuniteteve.

Kjo iniciativë ka marrë kryesisht formën e kampeve rinore dhe aktiviteteve të dialogut ndërmjet komuniteteve. Këto aktivitete i dhanë mundësi rinisë që të punojnë së bashku në hartimin e planeve komunale të veprimit mbi rininë dhe bashkëpunimin ndër-komunal. Në fund, këto plane veprimi u prezantuan dhe u miratuan në komunat e tyre përkatëse.

Në përputhje me zotimet e përcaktuara në Deklaratë, një numër komunash kanë realizuar me sukses aktivitete për nxitjen e diversitetit dhe vlerave të përbashkëta nëpër komunitete dhe pjesëtarët e tyre. Më poshtë janë disa shembuj se si Deklarata Ndërkomunale për Promovimin e Dialogut dhe Bashkëpunimit Ndërmjet Komuniteteve hyri në fuqi në rajone të ndryshme.

Shembuj të zbatimit të planeve të veprimit bazuar në deklaratën e nënshkruar përfshijnë marshimin e paqes në vitin 2017, i zhvilluar në komunën e Obiliqit, ku mbi 200 të rinj shqiptarë të Kosovës, serbë të Kosovës, ashkali, romë, boshnjakë, turq të Kosovës, marshuan së bashku me zyrtarët komunalë, përfshirë Kryetarin e Komunës së Obiliqit, për të dërguar një mesazh të tolerancës dhe pranimit të të gjitha komunitetet në Kosovë. Në tetor 2018, komuna e Mamushës, e banuar kryesisht nga turq të Kosovës, mbështeti dialogun ndërmjet komuniteteve duke organizuar një seancë solemne në sallën komunale dhe duke organizuar një vizitë në vende të ndryshme të trashëgimisë kulturore dhe fetare në qytetin e Prizrenit, përfshirë vendet fetare ortodokse, katolike dhe islame. Në një aktivitet tjetër të organizuar nga Kryetari i Komunës së Suharekës, aktivistët e komunitetit rom të Kosovës mbajtën një

<sup>127</sup> Aktiviteti i pilotuar është në realizim e sipër kështu që është shumë herët për të dhënë ndonjë vlerësim të rezultateve.

<sup>128</sup> Komuna Gjilan, Kamenicë, Novobërdë dhe Ranillug, gjersa Ferizaj, Shtërpçë dhe Kllokoti nënshkruan deklaratën më 2015;

<sup>129</sup> Komuna e Prishtinës, Graçanicës, Lipjanit, Shtimes, Obiliqit, Fushë Kosovës nënshkruan deklaratën më 2016.

<sup>130</sup> Prizreni, Dragashoi, Suhareka, Rahoveci, Mamushë, Malisheva nënshkruan deklaratën më 2017.

<sup>131</sup> Peja, Gjakova, Deçani, Klina, Istogu, Juniku nënshkruan deklaratën më 2018.

<sup>132</sup> Podujeva, Vushtrria, Mitrovica e Jugut. Skenderaj nënshkruan deklaratën më 2019.

<sup>133</sup> Zveçani, Leposaviqi, Zubin Potoku, Mitrovica e Veriut, Glllogoci, Hani i Elezit, Kaçaniku, Parteshi, Vitia nuk e kanë nënshkruar deklaratën deri më tani.



prezantim që kishte të bënte me stereotipet, motivimin e paragjykit, gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin si fenomene negative që pengojnë marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve.

Në rajonin e Gjilanit, pas nënshkrimit të deklaratës, ekipi i dialogut ndërkomunal hartoi një plan të përbashkët aktiviteti, i cili përfshinte disa projekte për të rinjtë. Ndër të tjera, në maj 2018, ekipi organizoi ekspozita pikturimi në Ferizaj, të pasuara nga kolonitë e artit ndërkomunitar që gjithashtu u organizuan si pjesë e të njëjtit projekt. Për më tepër, në korrik 2018, ekipi i dialogut ndërkomunal mbajti një panair të përbashkët për të promovuar produktet e sipërmarrësve të rinj në Shtërpçë. Që atëherë, panairi u organizua përsëri në vitin 2019.

Gjersa kjo seri vazhdonte dhe të rinjtë e ndryshëm nga e gjithë Kosova vazhdonin të kishin mundësi për bashkëveprim, komunat rrisnin aftësinë e tyre për zbatimin e iniciativave të tilla në mënyrë të pavarur. Me komunat e tjera që kanë nënshkruar deklaratat dhe me mbështetjen financiare të donatorëve të interesuar, praktikat e qëndrueshme për bashkëpunimin ndërkomunal gradualisht do të forcohen në Kosovë.

## 7. ASPEKTET RAJONALE: PROCESI I SHKUPIT

Raporti i OSBE-së për kthimin vullnetar 2014 vuri në dukje se bashkëpunimi i dobët rajonal ka kontribuar në problemet që lidhen me zhvendosjen nga Kosova. Problemet e diskutuara në raport përfshinin<sup>134</sup> mungesën e të dhënave të përbashkëta në rajon për numrin e personave të zhvendosur dhe nevojat e tyre, që paraqet vështirësi në bërjen e vlerësimeve të sakta të njerëzve që dëshirojnë të kthehen ose të kenë integrim lokal në vendin e tyre të zhvendosjes. Çështje tjera të identifikuar përfshinin bashkëpunimin e dobët dhe shkëmbimin e informacionit për nevojat e dokumentacionit personal të personave të zhvendosur, duke përfshirë validimin e ndërsjellë/njohjen e dokumenteve. Raporti theksoi se mungesa apo vështirësia në sigurimin e dokumenteve personale rezultoi në paaftësinë e personave të zhvendosur që të kthehen në Kosovë, apo të integrohen në vendin e tyre të zhvendosjes, dhe në disa raste madje mund të rezultonte në pashtetësi.<sup>135</sup> Raporti theksoi nevojën për bashkëpunim rajonal për zgjidhjen e këtyre çështjeve dhe ofroi rekomandime për institucionet e Ballkanit Perëndimor, veçanërisht Serbinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë Veriore.<sup>136</sup>

Ndonëse monitorimi i Misionit të OSBE-së në Kosovë tregon se këto çështje problematike vazhdojnë me këmbëngulësi, gjatë periudhës së raportimit janë bërë përparime substanciale nga institucionet e Kosovës për të formuar dhe mbajtur zyrtarisht kontakte të rregullta me aktorët rajonalë për të rënë dakord mbi zgjidhjet për popullsinë e zhvendosur dhe për të zhvilluar kornizë për veprim të përbashkët. Kjo kornizë veprimi më pas u funksionalizua në Kosovë përmes krijimit të Grupit Punues për Zbatim (GPZ), i cili do të diskutohet dhe vlerësohet tutje në këtë kapitull.

Sipas Strategjisë së Kosovës për Komunitete dhe Kthim 2014-2018, një nga objektivat strategjike është "krijimi i mekanizmave të bashkërendimit me donatorët dhe aktorët rajonalë dhe ndërkombëtarë".<sup>137</sup> Në vitin 2014, MKK, me ndihmën e Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe UNHCR, zhvilloi iniciativë rajonale dhe organizoi konferencën e parë rajonale kushtuar personave të zhvendosur nga Kosova. "Nisma ndër-institucionale për personat e zhvendosur nga Kosova", e njohur ndryshe si Procesi i Shkupit, është iniciuar në nëntor 2014 në Shkup, ku përfaqësues të nivelit të lartë nga Prishtina, Beogradi, Shkupi dhe Podgorica, përmes një *komunikate të përbashkët*<sup>138</sup> ranë dakord të punojnë në nivel rajonal për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova. Pikat kyçe të *komunikatës së përbashkët* përfshinin ngritjen e Grupit Punues Teknik Rajonal (GPT) dhe Forumit të nivelit të lartë për të mbështetur politikisht propozimet për bashkëpunim institucional për zgjidhje të qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova, përfshirë kthimet dhe integrimin në vendet e zhvendosjes.

<sup>134</sup> Shih Raportin e OSBE 2014, f. 20, *shënimi sipër 2*.

<sup>135</sup> Mungesa e qasjes apo përdorimit të dokumenteve të lëshuara nga institucionet në vendin e zhvendosjes apo vendin e kthimit (pra Kosovë) çon në probleme në dëshminë e gjendjes civile, dëshminë e të drejtave pronësore, qasjen në shkollim dhe në shërbime dhe ndihmë sociale. Rreziku i pashtetësisë është i rëndësishëm për popullatat e zhvendosura të cilët kanë humbur dokumentet e tyre, apo nuk i kanë pasur kurrë ato, apo kanë lindur në zhvendosje.

<sup>136</sup> Shih Raportin e OSBE 2014, f. 23 *shënimi sipër 2*.

<sup>137</sup> Masa 4.2, Strategjia për Komunitete dhe Kthim, *shënimi sipër 39*.

<sup>138</sup> Komunikata e Përbashkët e Konferencës së Nivelit të Lartë për Zhvendosjen nga Kosova, 27-28 Nëntor 2014, Shkup, në dispozicion në <https://www.osce.org/kosovo/129376>.

Që nga fillimi i procesit, GPT në përbërje të ekspertëve teknikë nga katër delegacionet zhvilluan së bashku një sërë dokumentesh që përshkruajnë fushat tematike të punës (të drejtat e pronësisë, siguria, dialogu dhe riintegrimi, dokumentacioni personal, planifikimi i zgjidhjeve dhe menaxhimi i të dhënave) dhe modalitetet e Procesit të Shkupit.<sup>139</sup> GPT gjithashtu zhvilloi pikat e veprimit, pjesë kjo kyçe e procesit që duhej ndërmarrë nga çdo institucion rajonal përkatës për të lehtësuar zgjidhjet e qëndrueshme në secilën fushë tematike. Dokumentet e pikave të veprimeve për sigurinë, dialogun dhe riintegrimin, të drejtat e pronësisë dhe dokumentacionin personal u miratuan zyrtarisht nga të gjitha delegacionet menjëherë pas hartimit të tyre. Miratimi i dokumenteve për menaxhimin e të dhënave dhe planifikimin e zgjidhjeve u vonua në mënyrë të konsiderueshme për shkak të natyrës më të gjerë të pikave të tyre të veprimit dhe varësisë së tyre në tre fushat tematike të lartpërmendura.<sup>140</sup>

Përkundër këtyre vonesave, në takimin e tretë të Forumit të nivelit të lartë në Beograd në qershor 2016, delegacionet pjesëmarrëse u angazhuan për zbatimin e pikave të miratuara të veprimit dhe shprehën këtë zotim përmes një *komunikate tjetër të përbashkët*.<sup>141</sup>

Gjatë vitit 2016, me ndihmë dhe mbështetje të Misionit të OSBE në Kosovë dhe UNHCR, MKK ka punuar në themelimin e Grupit Punues për Zbatim (GPZ) i cili pasqyron fushat tematike të Procesit të Shkupit. Nën punësit civilë nga institucionet e Kosovës<sup>142</sup> u emëruan si pika kontakti në secilin nëngrup përkatës (të njohur si nëngrupe pune për zbatim, e më vonë si nën-GPZ) dhe filluan punën për zbatimin e secilës pikë të veprimit. Ndërmjet takimit inaugurues të GPZ në mars 2017 dhe takimin koordinues të GPZ-së së gushtit 2018, nën-GPZ-të u takuan 27 herë për të avancuar pikat e miratuara të veprimit të Shkupit.<sup>143</sup> Gjatë vitit 2018, janë iniciuar disa takime bilaterale për të intensifikuar shkëmbimin e informatave në nivel ekspertësh dhe për të kërkuar zgjidhje teknike për çështje specifike nën çdo fushë tematike.

Nën-grupi Punues për Siguri, Dialog dhe Riintegrim ka hartuar udhëzuesin për reagimin nga mekanizmat e nivelit lokal për reagim ndaj incidenteve që ndikojnë tek komunitetet (shih më lart pikën 5).<sup>144</sup> Janë identifikuar edhe vendet e kthimit që kanë nevojë për kamera vëzhguese CCTV<sup>145</sup>, por edhe lokacionet që kanë nevojë për themelimin e Komiteteve Lokale për Siguri Publike (KLSP).<sup>146</sup> Për më tepër, çështja e nevojës për rritjen e numrit të anëtarëve nga komunitetet jo-shumicë në PK<sup>147</sup> është diskutuar në këtë nën-grup. PK pret që kjo të zgjidhet përmes rekrutimeve të reja nisur në vitin 2018, në të cilat ka disa pozita që janë rezervuar për

<sup>139</sup> MKK, Nisma Ndërinstitucionale për Zgjidhjet e Qëndrueshme për Personat e Zhvendosur nga Kosova, në dispozicion në <http://mzp-rks.org/en/images/dokumenta/ENG-Leaflet-SopjeProcess.pdf>.

<sup>140</sup> Po aty.

<sup>141</sup> Komunikata e Përbashkët nga Forumi i Nivelit të Lartë mbi Zgjidhjet e Qëndrueshme për Personat e Zhvendosur nga Kosova, 14 qershor 2016, Beograd, në dispozicion në <https://www.osce.org/kosovo/248371?download=true>.

<sup>142</sup> Ministria për Komunitete dhe Kthim si Kryesuese dhe anëtarë nga Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Agjencia e Regjistrimit Civil, si pikat kontaktuese të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

<sup>143</sup> MKK, Nisma Ndërinstitucionale për Zgjidhjet e Qëndrueshme për Personat e Zhvendosur nga Kosova, shënimi sipër 132.

<sup>144</sup> Pikat e veprimit 1.1-1.4 për Sigurinë, Dialogun dhe Riintegrimin.

<sup>145</sup> Pika e Veprimit 3.4 që lidhet me *Instalimin e kamerave CCTV në lokacionet përkatëse të kthimit*; pesë fshatra të të kthyerve në luginën e Osojanit në Istog janë identifikuar nga nën-grupi që të kenë nevojë për kamera vëzhguese, për të cilat janë dashur rreth 46,000 Euro për instalimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Në tetor 2018, MKK-ja ka financuar dhe përfunduar instalimin e sistemit CCTV në fshatin Osojan.

<sup>146</sup> Istogu dhe Klina janë identifikuar si komuna ku disa fshatra kanë shprehur nevojën për KLSP. Megjithatë, fshatarët tërheqin shprehjen e interesimit kur OSBE-ja përcjell interesimin e tillë.

<sup>147</sup> Pikat e veprimit 4.1 dhe 4.2 Sigurinë, Dialogun dhe Riintegrimin. Në këtë Pikë Veprimi, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka mbështetur PK-në në informim dhe inkurajim të komuniteteve që të aplikojnë.

pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë, por rekrutimi nuk ishte finalizuar ende në kohën e hartimit të këtij raporti.

Nën-grupi punues për të Drejtat Pronësore mirëpriti zhvillimet, siç tregohet në Pjesën 4 më sipër, që kanë ndihmuar në shtytjen përpara të një numri pikash veprimi. Gjatë periudhës së raportimit, Ligji për tatimin në pronë të paluajtshme<sup>148</sup> është ndryshuar, duke futur një dispozitë që liron pronarët e zhvendosur nga pagesa e tatimit të akumuluar për periudhën në të cilën nuk kanë mundur t'i qasen pronave të tyre. Krahas kësaj, pas rekomandimit nga Avokati i Popullit me 17 tetor 2017<sup>149</sup> për të adresuar çështjen e uzurpimeve dhe mungesën e zbatimit të dëbimeve, ndryshim/plotësimi i Ligjit për AKVKP vijimisht ishte iniciuar në dhjetor të vitit 2017, nga Zyra e Kryeministrit.

Nën-grupi punues për Dokumente Personale është nën-GPZ i vetëm me kontribut të mundshëm për pikat e kontaktit të emëruara nga delegacionet e tjera të përfshira në Procesin e Shkupit<sup>150</sup>. Duke pasur parasysh këtë, më 26 dhjetor 2017 nën-GPZ lëshoi një letër për delegacionet përkatëse për të caktuar pika kontakti për të zhvilluar dhe rënë dakord për fushat tematike në të cilat çështjet e dokumentacionit personal prekin personat e zhvendosur, si dhe të punojnë së bashku në zgjidhje. Ndërsa delegacioni i Beogradit u përgjigj me një listë të çështjeve tematike dhe Shkupi emëroi pikat e kontaktit, nën-GPZ vetëm pjesërisht i adresoi ato gjatë periudhës raportuese. Për shembull, nën-GPZ ra dakord të punojë në hartimin e një broshurë për personin e zhvendosur dhe komunitetet tjera të prekura për të ngritur vetëdijen për Udhëzimin Administrativ 05/2017 që rregullon procedurën për marrjen e letërnyoftimit të Kosovës, nëse personi mund të dëshmojë që ka qenë ish-shtetas i Republikës Federale të Jugosllavisë në Kosovë.<sup>151</sup> Një vendim i ri i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës u jetësua më 5 korrik 2018 për të adresuar njohjen e dokumenteve të lëshuara nga zyrat e dislokuara të regjistrimit<sup>152</sup>. Që nga 27 gushti 2018, ai është i zbatueshëm për të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë, si dhe për personat e zhvendosur që përmbushin kushtet e parashikuara sipas vendimit dhe kornizës ligjore në fuqi<sup>153</sup>. Për më tepër, më 17 dhjetor 2018, e njëjta ministri lëshoi një vendim tjetër për njohjen e pasaportave të lëshuara nga Qendra Koordinuese e Serbisë si dokumente të vlefshme për aplikimin për leje qëndrimi.<sup>154</sup> Së fundi, sipas Udhëzuesit për zbatimin e Rregullores për Kthim, ZKKK pritet të lëshojë certifikata që vërtetojnë vendbanimin me qëllim të marrjes së dokumentacionit personal. Gjatë periudhës së raportimit, ZKKK-të në Obiliq, Viti, Klinë dhe Prizren shfrytëzuan këtë dispozitë për të mundësuar qasje më të lehtë për të kthyerit në dokumente personale.

---

<sup>148</sup> Ligji nr. 06/L-005 për tatimin në pronë të paluajtshme, shënimi 72 më sipër.

<sup>149</sup> Raport me rekomandime Ex-officio nr.551/2017 në lidhje me Heqjen e kompetencave të caktuara të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, sipas Ligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, 17 tetor 2017.

<sup>150</sup> Pika e veprimit 5.1 për dokumentet personale.

<sup>151</sup> Udhëzimi Administrativ e bën më të lehtë për individët që kanë qenë shtetas të RFJ-së dhe kanë pasur vendbanim të përhershëm më 1 janar 1998. Këtë mund ta dëshmojnë me librezë shëndetësore, patentë-shofer, indeks studentit, librezë punësimi, dëshmi të shtetësisë së RFJ-së.

<sup>152</sup> Vendim i Ministrisë së Punëve të Brendshme Nr. 296/2018, 5 korrik 2018. Ndonëse jashtë periudhës së raportimit, ky Vendim skadoi më 5 korrik 2019, përmes Vendimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 785/2018, 15 korrik 2019.

<sup>153</sup> Nën-grupi punues për dokumente personale ka pranuar megjithatë informacione se në disa raste personat e zhvendosur nuk mund të udhëtojnë në pika kalimi me këto dokumente.

<sup>154</sup> Vendim i Ministrisë së Punëve të Brendshme Nr. 321/2018, 7 dhjetor 2018.

Procesi i Shkupit ka qenë thelbësor për fillimin dhe sigurimin e dialogut dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm në rajon në drejtim të gjetjes së zgjidhjeve për njerëzit që vazhdojnë të jenë të zhvendosur. Përgjatë gjithë procesit, institucionet e Prishtinës, Beogradit, Shkupit dhe Podgoricës kanë miratuar katër *komunikata të përbashkëta*. *Komunikata e parë e përbashkët* theksonte përkushtimin ndaj procesit, e dyta vendosi kornizën praktike për orientimin e punës operative të institucioneve pjesëmarrëse, e treta shënoi fillimin e fazës së implementimit, ndërsa e katërta shprehte kënaqësinë me hapat konkretë të bërë drejt zbatimit të pikave të veprimit, sidomos në lidhje me themelimin e GZP të Kosovës. *Komunikata e pestë e përbashkët* nuk u nxor pasi që Forumi i Nivelit të Lartë 2018 u shty, ndërkohë që vetëm GTP u mbajt në dhjetor 2018 për të shqyrtuar përparimin në fushat tematike. Aty u dakordua që ishte e nevojshme të ketë me shume shkëmbim informacionesh të nivelit eksperte për të gjetur zgjidhje teknike për çështje specifike në fushat tematike, posaçërisht përmes takimeve bilaterale.

Derisa është shënuar përparim gjatë periudhës së raportimit, duhet theksuar që procesi është shtyrë përpara dhe financiar kryesisht nga Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe UNHCR-ja. Me përjashtim të Forumit të parë të Nivelit të Lartë që është kërkuar nga Ministri për Komunitete dhe Kthim, të gjitha mbledhjet janë iniciuar dhe organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe UNHCR-ja. Në një moment pozitiv, MKK-ja ka arritur të bëjë publike dokumentet dhe modalitetet e zotimeve dhe punës së nën-grupit punues, duke publikuar broshurë për Procesin e Shkupit në faqen e saj të internetit.<sup>155</sup>

Në Kosovë, kapacitetet e nën-grupeve punuese, sidomos kryesuesve përkatës<sup>156</sup>, janë zhvilluar gradualisht me përkrahjen e UNHCR-së dhe Misionit të OSBE-së në Kosovë, përkundër fillimit relativisht të ngadalshëm të procesit të implementimit. Pjesëtarët e nën-grupit punues kanë shprehur përkushtimin e tyre për të shtyrë përpara një numër pikash veprimi, siç përmenden më lart. Pritet të shihet se sa përkushtim e iniciativë do të ofrohet në procesin e implementimit nga institucionet e tyre amë.

Miratimi i vonuar i pikave të veprimit tek menaxhimi i të dhënave dhe planifikimi i zgjidhjeve në nivel rajonal ka vonuar edhe implementimin në këtë fushë. Këto pika veprimi zgjerojnë llogaridhënien përtej Prishtinës, tek institucionet në Podgoricë, Beograd dhe Shkup. Përmes implementimit të tyre, zgjidhjet do të mundësoheshin në vendin e zhvendosjes, përmes politikave integruese. Derisa janë raportuar disa zgjidhje nga këto institucione, duke përfshirë mbylljen e Kampit Konik dhe ndërtimin e banesave për qëllime integrimi nga institucionet e Podgoricës, çështjet dhe politikat e integritimit nuk janë diskutuar zgjerimisht gjatë takimit të GPT-së, derisa zgjidhja e kthimit ka qenë fokusi kryesor. Derisa përparimi tek politikat e integritimit në Beograd, Podgoricë e Shkup është përtej fushëveprimit të këtij raporti, është me rëndësi të nënvizohet që qëllimi i Procesit të Shkupit është të lehtësojë të dy zgjidhjet - edhe kthimin edhe integrimin në vendet e zhvendosjes.<sup>157</sup>

<sup>155</sup> MKK, Iniciativa ndërinstucionale për Zgjidhje të qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova, shënimi 132 sipër.

<sup>156</sup> Kryesuesit e nën-grupeve punuese janë shërbyes civilë nga MKK-ja.

<sup>157</sup> Komunikata e përbashkët nga Konferenca e Lartë për Zhvendosjet në Kosovë, shënimi 128 sipër.

## 8. KONKLUZA

Gati 20 vite pas përfundimit të konfliktit të Kosovës, përkundër ndihmës substanciale ndërkombëtare dhe programeve të dedikuara, për një numër të madh të personave të zhvendosur, qofshin brenda apo jashtë Kosovës, nuk ka zgjidhje të qëndrueshme që do t'i mundësonin atyre të jetonin jetë stabile me dinjitet. Që prej dhjetorit të vitit 2018, vetëm 28,111 persona të zhvendosur janë kthyer në Kosovë, sipas statistikave të UNHCR-së, me një trend në rënie me kalimin e kohës. Shkalla e ulët e kthimit dhe prirjet në rënie konfirmojnë që çështjet që pengojnë kthimin ende rezistojnë, duke e marrë parasysh që situatat e zhvendosjes së zgjatur, *vetvetiu*, çojnë në interesim më të ulët për kthim.

Janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në adresim të çështjes së zhvendosjes nga Kosova si pasojë e konfliktit, përmes zhvillimeve institucionale, ligjore e të politikave, ndërsa është arritur përparim me kthimet. Në janar të vitit 2018, është miratuar dhe ka hyrë në fuqi Rregullorja nr. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe për zgjidhje të qëndrueshme. Ky është hap i rëndësishëm në konsolidim të procedurave dhe bashkërendim të mekanizmave të ndryshëm të përfshirë në procesin e kthimit. Megjithatë, kjo centralizon fuqinë vendimmarrëse për ofrimin e ndihmës emergjente.

Një shqyrtim i Misionit të OSBE-së i veprimeve të ndërmarra në mbështetje të kthimit ka konkluduar që komunat shpesh nuk sigurojnë përmbushje sistematike të obligimeve të tyre. Shumë mekanizma komunalë nuk funksionojnë në mënyrë adekuate apo rregullisht, ndërsa ofrimi i ndihmës në kthim mbetet tejte e varur nga përkrahja e donatorëve.<sup>158</sup>

Çështjet pronësore kanë vazhduar të pengojnë përparimin në kthim. Ri-uzurpimi i paligjshëm i pronave dhe pengesat ndaj ndarjes së tokave për programet e ndihmës në banim kanë penguar personat e zhvendosur në ushtrimin e të drejtave të tyre pronësore. Përparim është vërejtur edhe në fushën e ligjvënies edhe të politikave, me Ligjin e ri për tatimin në pronë të paluajtshme, si dhe Strategjinë për të drejtat pronësore, por rezultatet konkrete janë iniciuar kryesisht nga bashkësia ndërkombëtare.

Incidentet e sigurisë dhe kundërshtimi i kthimit nga komunitetet pritëse vazhdojnë të ndikojnë në të kthyerit. Përderisa shumica e incidenteve përfshijnë krime të vogla<sup>159</sup>, ato ende kanë ndikim negativ te perceptimi i të kthyerve, posaçërisht kur rastet e raportuara mbesin të pazgjidhura dhe kryerësit e paidentifikuar Udhëzuesi për reagimin nga mekanizmat e nivelit lokal ndaj incidenteve që prekin komunitetet, miratuar në janar të vitit 2018, pritet të përmirësojë reagimet institucionale, të cilat nuk kanë qenë gjithmonë efektive, apo kanë munguar krejtësisht.

Në anën pozitive, bashkëpunimi rajonal për gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme është përmirësuar që prej fillimit, më 2014, të Procesit të Shkupit, udhëhequr nga MKK-ja, si dhe mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe UNHCR-ja. Procesi i Shkupit ka qenë jetik për dialogun dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm në rajon për gjetjen e zgjidhjeve për personat e zhvendosur. Në nivel zbatimi, zhvillime të ndryshme e të rëndësishme në fushën e

<sup>158</sup> Shih pjesën 2 sipër, f. 6.

<sup>159</sup> Llojet e tjera të incidenteve të sigurisë janë të mbuluara në pjesën pesë.

sigurisë, drejtave pronësore (p.sh. tatimi në pronën e paluajtshme) dhe dokumentacionit personal<sup>160</sup> i kanë avancuar në mënyrë domethënëse pikat e veprimit sipas Procesit të Shkupit, dhe rrjedhimisht kanë ndihmuar në gjetjen e zgjidhjeve për personat e zhvendosur.

---

<sup>160</sup> Shih pjesën 7 sipër, f. 27

## 9. REKOMANDIME

### **Për institucionet qeveritare në përgjithësi:**

- Të avancohet bashkëpunimi institucional ndërmjet qeverisë dhe institucioneve komunale, me përgjegjësi për lehtësimin e procesit të kthimit.
- Të trajtohet riuzurpimi i pronave, përmes ndryshim e plotësimit të ligjit për AKVKP-në, duke përfshirë dëbimin e shumëfishtë tek pronat e uzurpuara.
- Të caktohet përgjegjësia tek një trup i vetëm që do të merrej me bashkërendimin ndërmjet qeverisë dhe organeve komunale për çështjet që kanë të bëjnë me ndarjen e tokave.
- Të vazhdohet bashkëpunimi përmes nën-Grupeve Punuese për Zbatim nga Procesi i Shkupit që të ndihmohet avancimi i pikave të mbetura të veprimit në të gjitha fushat tematike.

### **Për Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthimit:**

- Të përforcohet bashkërendimi me komunitat dhe zyrat komunale për komunitete dhe kthim, duke përfshirë përmes ofrimit të këshillave dhe udhëzimeve, si dhe mbikëqyrjes dhe veprimeve pasuese përkatëse me komunitat në të cilat monitorimi i OSBE-së ka identifikuar mangësi në veprimtarinë e ZKKK-ve.
- Të shtohen përpjekjet për zbatimin e pikave të veprimit të dala nga Procesi i Shkupit, si dhe të merret përsipër pronësia mbi vetë procesin.
- Të bëhen publike, në baza të rregullta, dokumentet dhe modalitetet e zotimeve dhe punës së Grupit Punues për Zbatim në kuadër të Procesit të Shkupit.
- Të merren veprime të përbashkëta në zhvillim të dialogut ndërmjet komunitetit të kthyer dhe atij pritës.

### **Për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor:**

- Të përkrahet financiarisht zbatimi i programeve komunale të banimit.

### **Për Ministrinë e Financave:**

- Të përforcohen kapacitetet e AKVKP-së për zbatimin e urdhrave për rrënim dhe skemave të kompensimit përmes ndarjes së buxhetit të nevojshëm.

### **Për Policinë e Kosovës (PK):**

- Të reagohet shpejtë dhe efektivisht ndaj incidenteve që prekin komunitetet në pakicë numerike në nivel komune.
- Të merren masa për të rritur komunikimin dhe mirëbesimin ndërmjet komuniteteve dhe PK-së, përfshirë përmes mekanizmave ekzistues, siç janë KKSBB-të dhe KLSP-të.
- Të informohen viktimat për rezultatet e hetimeve.
- Rindarja e resurseve të PK të reflektojë nevojën e zonave të banuara nga komunitetet joshumicë për prani të PK-së.
- Të rritet patrullimi në vendet e kthimit dhe zonat e banuara nga komunitetet joshumicë.



**Për komunitet dhe ZKKK-të:**

- Të zbatohet Rregullorja e miratuar së fundi nr. 01/2018 për kthim të personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme dhe të sigurohet funksionim efektiv i të gjithë mekanizmave komunalë që e mbështesin procesin e kthimit, në pajtim me kornizën ligjore.
- Të ndiqen të gjitha opsionet e mundshme për ndarjen e tokës për projektet që kanë të bëjnë me kthimin, duke përfshirë këmbimin e tokës me AKP-në dhe rikthimin e pronësisë mbi parcelat e caktuara të tokës të ndërmarrjeve shoqërore nën administrimin e AKP-së.
- Të bëhen kontakte të rregullta me të kthyerit për të siguruar riintegrimin e tyre efektiv.
- Të bëhen kontakte të rregullta me personat e zhvendosur, pronat e të cilëve janë prekur me procesin e shpronësimit.
- Të trajtohen shpejtë dhe efektshëm incidentet ndëretnike përmes zbatimit të Udhëzuesit të sapomiratur për reagimin e mekanizmave lokalë ndaj incidenteve që prekin komunitetet.
- Të ketë angazhim proaktiv në trajtimin e rezistencës ndaj kthimit nga ana e komuniteteve pritëse, si dhe të lehtësohet dialogu dhe iniciativat për zgjidhjen e problemeve në ato raste. Të angazhohen të gjithë mekanizmat e pjesëmarrjes së komuniteteve në ato nisma.

**Për institucionet në rajonin e Ballkanit Perëndimor që kanë përgjegjësi për personat e zhvendosur dhe të kthyerit:**

- Të vazhdojë zbatimi i pikave të veprimit, të dakorduara në kuadër të Procesit të Shkupit për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme për personat e zhvendosur në formë të kthimit ose të integritetit në lokacionin e zhvendosjes.
- Të vazhdohet shfrytëzimi i Procesit të Shkupit si forum për dialog dhe gjetje të zgjidhjeve, sidomos në lidhje me menaxhimin e të dhënave dhe çështjet e dokumentacionit personal.

# SHTOJCA

**TABLA I: FUNKSIONIMI I MEKANIZMAVE LOKAL PËR PROCESIM TË KËRKESAVE PËR KTHIM, NË NIVEL KOMUNE (2015-2017)**

Grupet punuese komunale për kthim	2015			2016			2017		
	Numri i takimeve	Rastet e shqyrtuara	Rastet e aprovuara	Numri i takimeve	Rastet e shqyrtuara	Rastet e aprovuara	Numri i takimeve	Rastet e shqyrtuara	Rastet e aprovuara
Ferizaj									
Gjilan	4	13	18	3	23	13	0	0	0
Hani i Elezit									
Kaçanik									
Kamenicë	0	0	0	1	9	9	0	0	0
Kllokot									
Novobërdë	1	0	0	1	12	8	1	6	6
Partesh									
Ranillug									
Shtërpçë	3	16	16	5	35	30	3	41	7
Viti									
Leposaviq									
Mitrovicë e jugut	1	8	4	1	2	0	2	39	27
Skenderaj/Srbica	0	0	0	1	5	0	0	0	0
Vushtrri									
Zubin Potok									
Zveçan									
Glllogoc									
Podujevë									
Mitrovicë e veriut									
Deçan									
Gjakovë	0	0	0	1	14	12	0	0	0
Istog	1	0	0	4	77	20	1	0	0
Junik									
Klinë	1	0	0	4	100	12	0	0	0



Zveçan	2	5	5	9	9	9	9	3	9	5
Glllogoc	0	0	0	1	1	0	0	2	1	1
Podujevë	0	0	0	1	1	1	1	0	0	0
Mitrovicë e veriut	3	1	1	4	8	3	3	3	42	10
Deçan	0	0	0	0	0	0	0	1	3	1
Gjakovë	0	0	0	3	47	24	24	2	138	47
Istog	0	0	0	6	262	28	28	4	231	8
Junik										
Klinë	0	0	0	6	200	20	20	6	463	100
Pejë	0	0	0	6	190	21	21	8	106	26
Fushë Kosovë	1	5	5	3	19	19	19	2	60	15
Graçanicë	8	2	2	5	7	4	4	4	114	16
Lipjan	9	62	62	2	18	0	0	16	72	12
Obiliq	5	22	22	5	56	12	12	9	140	120
Prishtinë	7	3	3	2	4	02	02		23	6
Shtime	0	0	0	2	2	1	1	1	5	0
Dragash	0	0	0	0	0	0	0	2	7	6
Malishevë										
Mamushë										
Prizren	0	8	0	1	67	67	67	8	329	148
Rahovec	1	1	1	3	4	4	4	1	25	6
Suharekë	0	0	0	0	0	0	0	1	61	33
<b>Total</b>	62	180	162	111	1244	308	112	2120	723	

